

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7631 E shtunë 25 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Eseja **Ditës**
Në Shqipëri shkova për herë të parë në vitin 1970 me ambasadorin francez Pierre Sebillaud. Krugën nga Beogradi ku punoja si diplomat italian e bëmë ...
Vijon në faqen 21

Nga PAOLO FORESTI
Kur Shqipëria ishte e vetmuar në fatin e saj


Opinion **Ditës**
Pak orë më parë, presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç në një fjalë para medias së vendit të tij ceku me shumë kujdes edhe problemin e shërbimit ushtarak ...
Vijon në faqen 22

Nga BEN ANDONI
Erdhi koha që t'i veshim rrobat e ushtrisë?!



Kryeministri: S'kemi frikë nga drejtësia
"Washington Times": Vetingu i jep fuqi qeverisë. Rama: PD paguan për artikujt

Përgjigjet Basha: Ke blerë ambasadorët dhe drejtësinë me para droge. Popullin s'e kap dot
VALENTINA MADANI
"The Washington Times" kritikon sërish qeverinë shqiptare. Një shkrim tjetër ka pasuar atë për ambasadorin amerikand Donald Lu, për të cilin u tha se ka punuar kundër presidentit Donald Trump dhe ...
Në faqen 4

POLICIA NDALON XHAXHAIN DHE DY NIPERIT, SHERRI PAS KONFLIKTIT **KORÇE, 56-VJECARI VRITET ME GRUSHTA DHE SHKELMA**

E motra e Novruz Fiqit: U kërcënua dhe u dhunua nga fqinjët.
Paralajmërimi: I thanë që do ta vrisnin se thasët me kanaçe vinin erë të keqe



(Në foto) Policia në vendin e ngjarjes

PASOJAT E DIKTATURES
Meta dekoron të mbijetuarit e Tepelenës: Pajtimi arrihet me falje
Në faqen 3

RRUGA SARANDE-KSAMIL
Aksidentet marrin jetë të tjera, çifti italian përplaset me motor
Në faqen 7

MBYLLET KAMPI I LRI
Kryemadhi, të rinjve: Jeni brezi i përmbysjes së diktaturës së kimit
Në faqen 3

ARSIMI I LARTE
Bursa në Itali për studentët e UT, ja kriteret për kandidatët
Në faqen 11

DRAMA E RONALDO KASAJT

Dëshpërimi i një prindi: Tumori po më merr djalin, doktori tha "s'kemi ilaçe"
Në faqen 10

BLUE TOOTH Kallashi: Ja pse u largova nga Kosova. Dua të iki atje ku s'më njohin
Kërcimtarja: Kam fituar 10 mijë euro në natë VIP-at në plazh, ja fotografitë. Fjorentina e "BB": E vërteta e lidhjes

Nga PAMELA ALIAJ
Ajo 'u zhdruk' papritur prej disa vitesh si nga rrjetet sociale ashtu edhe nga mediat rozë për të mos qenë më në qendër të vëmendjes me provokimet e saj të shpeshta. Por tashmë atë e shohim sërish. Don-

jeta Kosumi, e njohur ndryshe me nofkën 'Kallashi' i është rikthyer rrjeteve sociale dhe vendit të saj të lindjes, Kosovës. Ndërsa në postimin e saj të fundit, kohë më parë, njoftoi se do të hiqte dorë nga kërcimi, tashmë i është ..
Suplement

VIKTIMAT E KOMUNIZMIT DEKORIMI

Kastriot Dervishi: Koncepti "memorial kombëtar" s'ka mbështetje te legjislacioni shqiptar

"Kampi i Tepelenës duhet të jetë muze kombëtar"

Kritikat e argumentet e ish-drejtorit të Arkivit

Fatmira Nikolli

Letra e panevojshme e ish-kongresmenit Dio guardi drejtuar kryetarit të Bashkisë së Tepelenës, në kohën kur ka një lësh administrativ në lidhje me statusin e kampionit të Tepelenës, më shtyn të bëj të njohura disa veprime të deritanishme jo në përpunje me legjislacionin shqiptar. Qysh në fillim e them se i vetmi veprim i duhur është shpallja muze kombëtar me emrin: "Kampi i internimit tela me gjemba Tepelenë në vitet 1949-1953". Emërtesa zyrtare e kohës ka qenë "Kampi i Tepelenës". Prej këtu nis edhe marrja në konsideratë e kriterit historik. Kushtet e burgut të hapur të këtij kampi, prania e madhe e fëmijëve, si dhe rrethimi tela me gjemba, janë fakte që dalin në dokumentet zyrtare. Për fat të keq, në trajtimin e statusit të vendit të kampionit në fjalë, janë përfshirë institucione që nuk kanë asnjë lidhje me procesin e shpalljes së një muzeu të tillë, të cilët në rastin më të mirë mund të jenë vetëm propozues. Koncepti "memorial kombëtar", i përdorur në korrespondenca me institucione nuk gjen mbështetje te legjislacioni shqiptar. Në rast të tjera vendos Këshilli i Ministrave. Le të shohim disa veprime të muajve të fundit. Bashkia e Tepelenës shkel e para ligjin. Këshilli Bashkiak i Tepelenës me vendimin nr.40, datë 30.11.2017 "Për miratimin e objekteve prioritare të investimeve për vitin 2018", ndër të tjera ka vendosur ndërtimin e "Memorialit kombëtar të kampeve të punës së detyruar", vendim që ma sa u duk ishte "lexuar" me vëmendje edhe nga ish-kongresmeni i sipërcituara. Si bazë ligjore e vendimit, është përdorur neni 54/k i ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", për kompetencat e këshillit bashkiak, të cilin thuhet se këshilli bashkiak i njëjtit: "miraton norma, standarde e kriteret



KAMPI Emërtesa zyrtare e kohës ka qenë "Kampi i Tepelenës". Prej këtu nis edhe marrja në konsideratë e kriterit historik. Kushtet e burgut të hapur të këtij kampi, prania e madhe e fëmijëve, si dhe rrethimi tela me gjemba, janë fakte që dalin në dokumentet zyrtare



këtij, për çdo gjë duhej operuar me ligjin nr.9386, datë 4.5.2005, "Për muzetë". Shihet qartë se nuk është zbatuar fare ky ligj. Pavarësisht se thuhet një mijë gjëra e nënshkruhen çdo muj marrëveshje teatrale bashkëpunimi, ende nuk dimë në pronësi të kujt është sot territori ku mund të ngrihet kompleksin muzeal, i bashkisë apo Ministrisë së Mbrojtjes? Ishte edhe një të rrethanohej këtij vit. Më 17.5.2018, Kuveni i Shqipërisë miratoi ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muze kombëtarë 10 të tillë. Kishin rastin të shpallëshin me këtë rast kampi i punës së detyruar të të burgosurave në Spaç dhe kampi i internimit në Tepelenë. Nuk u shfrytëzua ky rast. Autoriteti propozoi përfshirjen në ligj të vendete të pushkatimit në tipologjinë e pasurive kulturore (pavarësisht se nuk ka bazë të zbatohet), por ngurroi të fuste edhe dy rastet në fjalë. Për të gjitha sa thashë më sipër, tashmë muzeu kombëtar mund të ngrihet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Këshillit Kombëtar të Muzeve në Ministrinë e Kulturës. Kësisoj, duhet pezulluar çdo veprim që bie në kundërshtim me legjislacionin tonë, duke bërë të mundur të miratohet sa më shpejt muzeu kombëtar i kampionit të internimit tela me gjemba i Tepelenës. Do ishte me vend që Autoriteti t'i shtoheshin kompetencat duke e kthyer në një agjenci koncertesh e ekspozitash. Të paktën do ishte të sigurt se legjislacioni do zbatohet në fushat e tjera. *Ish-drejtor i arkivit të Ministrisë së Brendshme

Historia e kampionit famëkeq

Ish-kampi i internimit i Tepelenës i përngjan një kampi që përdorimi në të cilin janë humbur qindra jetë. Zanafillën e ndërtimit të kompleksit muzeal e shënojnë dy kazemat të ndërtuara nga ushtria fashiste italiane në vitin 1939. Kazemat shërbyen si bazë ushtarake e ushtrisë fashiste në luftën italo-greke. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, në vitin 1949 ky reparat ushtarak u shndërrua në kamp internimi dhe



shërbeu si i tillë deri në vitin 1953. Nga viti 1953 deri në vitin 1990 ai shërbeu si reparat ushtarak për ushtrinë e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe pas vitit 1990 ky kompleks humbi çdo funksion. Në kampin e Tepe-

lenës kanë ndërruar jetë rreth 300 fëmijë, kryesisht nga uria dhe keqtrajtimi. Fëmijët përfunduan në këtë qendër brutale internimi në të vetmin "faj" se ishin fëmijë ose nipa të prindërve, gjysheve ose kushërinjve që për pushtetin popullor ishin kategorizuar si armiq politikë. Këtyre fëmijëve iu hoq edhe e drejta e pasjes së një varri, duke i varrosur buzë lumit, me qëllim që ujërat e Vjosës t'ua merrnin eshtrat me vete, duke i zhdukur kështu gjurmët e këtij makabriteti.

për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik". Shihet qartë që Këshilli Bashkiak i Tepelenës ka tejkaluar kompetencat, vendimi nuk ka referim të duhur ligjor dhe rrjedhimisht ky vendim duhet të jetë nul.

VIJON AUTORITETI Pas këtij vendimi, me shkresën nr.52/1 prot., datë 29.1.2018, Autoriteti i dosjeve i drejtohet Ministrisë së Kulturës me kërkesën "për bashkëpunim" për "Memorialin kombëtar të kampeve të punës së detyruar në Tepelenë". Pra, Autoriteti, kreu pa tagër ligjor në rastin e

ndërtimit të muzeve, i vendos emrin e vet këtij procesi, duke cituar një bazë ligjore të paqenë, si dhe konventa ndërkombëtare kreu pa ligj. Pastaj po vetë Autoriteti e ngatërron edhe më shumë kur thotë se projekti kombëtar është miratuar edhe nga një njësi vendore si Bashkia e Tepelenës. Pra, projekti në formë është kombëtar, por në thelb del vendor. Në shkresë thuhet se miratimi i këtij memoriali do ishte hapi i parë drejt kthimit të kompleksit në muze "për kampet e punës së detyruar në Shqipëri". D.m.th. nuk duhet bërë hapi i parë ligjor duke e vendosur menjëherë statutin e muzeut, por do bëjë

Autoriteti "nxehejen" për kohë të pacaktuar, e pastaj shohim e bëjmë në zbatim ligji. Këta që do ndriçojnë gjithë dynjanë, janë të pandriçur për vete, ende nuk dinë se kampi nuk ka qenë kamp i punës së detyruar, sepse i tillë është ai që ndërton një vepër apo kryen punime në bujqësi e miniere. Sa për ilustrim historik, sipas raportit të datës 13.1.1951 të Degës së Burgjeve dhe Kampeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kampi i Tepelenës nuk përmendet fare i përfshirë në punët e detyruara. Ndryshe ndodh këtë kohë me Kampin e Valiasit ku raportohet puna jo vetëm e të internuarve sh-



Presidenti Ilir Meta në Përkujtimoren e Viktimave të Sistemeve Totalitare, në Tepelenë.

Historia e dhimbshme e nënave që varrosën fëmijët e tyre në Kampin famëkeq të Tepelenës

Meta dekoron të mbijetuarit e Tepelenës: Drejtësi dhe lustracion

"Pajtimi, arrihet duke kërkuar të falur"

Valentina Madani

Gjelë Gjokola dhe Mrikë Gjokola, dy gra malë sore nuk u ndalën për 55 vjet, deri sa rigjetën eshtrat e bijave të tyre të vdekur në Turan të Tepelenës. Ato humbën fëmijët 3-vjeçarë në internim. Fëmijëve iu siguria një vend prehjeje i identifikueshëm dhe pas gjysmë shekulli, nënat e tyre rifituan të drejtën për ta kujtuar fëmijën njerëzisht. Historia e Drande Jakjas, e dekoruar pas vdekjes, rrëqeth këdo që e dëgjon. Drande Jakja jetoi edhe gati 70 vjet të tjera pas vdekjes së të birit. Jetoi një shekull, ndërsa historia e saj e pazakontë do ta kalojë shekullin e jetës së saj. Një histori makabre, dhimbjeje dhe nderi. Drande Jakja, e cila ruajti 7 javë pranë vetes trupin e pajetë të të birit në kampin e Tepelenës, u dekorua pas vdekjes, nga Presidenti Ilir Meta. Me 23 gusht, në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, u organizua Dita Muze/Memorial në Tepelenë. Simpoziume shkencore, performancë artistike, ekspozita dokumentare, dëshmi dhe koncerte, një vend i veçantë iu rezervua nderimit të të mbijetuarve të kampit të Tepelenës. Në praninë të të mbijetuarve apo të të afërmeve të viktimave të përndjekjes komuniste, Presidenti i Republikës Ilir Meta nderoi me titull Për meritat të veçanta civile, disa nga simbolët e mbijetesës dhe të dhimbjes. Mes tyre janë tri nëna, që jeta u rezervoi fatin e tmerrshëm, të varrosin e zhvarrosnin me duart e tyre fëmijët e mitur, që vdekja u mori në kampet e shfarosjes. Presidenti, Ilir Meta, ndërsa nderoi kujtimin e të internuarve dhe viktimave të kampit, kërkoi zbardhjen e të vërtetës për t'u treguar të rinjve se nuk duhet të lejojnë kthimin e së shkuarës. "Kujtimi i merrveve të së kaluarës është detyrë e të gjithëve ne, si shenjë respekti dhe detyrimi për të gjitha viktimat që kanë vuajtur dhe kanë vdekur dhe si një mënyrë për t'u siguruar që kjo nuk do të ndodhë më për gjeneratën e ardhshme. Ky kujtim, gjithashtu, mbështet dhe ushqen angazhimin tonë për të zhvilluar demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të luftuar



GENTIANA SULA

Gentiana Sula, drejtoresha e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përveçse dha detaje për projektin që do të garantojë memorien historike dhe një muze për kampin e foshnjave, vendin ku persekutoan dhe humbën jetën edhe dhjetëra foshnje nën moshën 1 vjeç, tha se gjithçka do të ecë paralelisht, hapja e dosjeve dhe dënimi i krimeve të komunizmit.



Përfundon aktiviteti i LRI në Jalë

Kryemadhi, të rinjve: Jeni brezi i përmbyesjes së diktaturës së krimit

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, nga kampi i të rinjve në Jalë ka parashikuar një shtator të trazuar në sferën politike. "Shtatori do të sjellë ngjarje në politikën shqiptare për shkak të kësaj gjendje të keqe. Qeveria ndjen kënaqësi kur terrorizon dhe mashtron popullin e saj. Qeveria ndjehet krenare kur poshtëron qytetarët e saj. Kjo është një qeveri që nuk meriton grushtin, por poshtërimin, pasi shtypin, shfrytëzojnë dhe poshtërojnë popullin e tyre. Ju jeni brezi që do të hyni në histori për përmbyesjen e diktaturës së krimit dhe të drogës. Përmbyesja nuk do të vijë nga dhuna, por nga zemra juaj", deklaroi Kryemadhi. "Jeni shumë të vegjël, por jeni dhe shumë të fortë. Ky grup mjaft modest arriti kulmin e tij, me pasion dhe me forcën për të cilin të gjithë kemi nevojë. Dua të them se ky grup modest i juaj, që brenda vetes ka entuziazëm, ju thatë që një njeri mund të ndryshojë botën duke u dhënë shpresë të tjerëve. Ëndrrat janë ato që ndryshojnë botën dhe jetën tonë, janë motivi që inspirojnë motivin për të ardhmën e tyre. Sot jemi në një demokraci të pa konsoliduar, fantazmat e diktaturës po shfaqen në formën e bandave. Nëse në komunizëm përplasnim me Sigurimin e Shtetit, sot përballimi me diktaturën e drogës dhe të krimit, që është më e fortë. Kjo diktaturë po mbështetet nga narko-shteti", tha kryetarja e LSI.

Pervizi dokumentoi me thëngjill Aushvicin shqiptar

Dëshmia e Terezinës, 8-muajsh e internuar dhe rikthimi pas 64 vitesh

Mrike Gjokola është një prej nënave që varrosi me duart e saj fëmijën e vdekur në kampin famëkeq të Tepelenës, për t'i dhënë një varr të identifikueshëm vetëm pas 55 vitesh. Ajo shpërtheu në lot ndërsa kujtoi të shkuarën aty, pasi u nderua me titullin "Për meritat të veçanta civile" nga Presidenti i Republikës Ilir Meta bashkë me Drandë Jakjen dhe Gjelë Gjokolën me të cilat ndau të njëjtën histori të humbjes së fëmijës aty. "Më keq se këtyre asnjërit s'i ka dalë, kanë dalë fare krejt. Megjithatë, faleminderit shumë",-tha Mrike Gjokola. Rikthehet pas 64-vjetësh në kampin famëkeq të Tepelenës, aty ku kaloi 5 vjet të fëmijërisë së saj. "Erdha 9 muajsh dhe ika kur u mbyll në '54",-shprehet Terezina Çapaliku. Lekë Përvizi është një tjetër i mbijetuar i kampit, që ata që u internuan nga regjimi komunist, e cilësojnë si Aushvicin shqiptar. Ai i ka të dokumentuara ato përmes vizitimeve, të cilat u ekspozuan me me 23 gusht në Tepelenë. Leka i dënuar nga 1945 deri në 1990, në Berat, Tepelenë, Porto-Palermo, Kamzë, Lushnjë, Kuç me heqjen e të gjitha të drejtave, bashkë me familjen e vet, Leka përshkoi një kalvar të gjatë internimesh dhe burgu, ku humbi gjyshen, nënën, vëllanë dhe ku edhe krijoi familje me një vajzë, që i mbijetoi Tepelenës. Gjyljana Malajn. "Shërbimi që i ka bërë Leka historisë lidhet me dëshmitë e gjalla që ai i ka sjellë deri në të sotmen, ku duke përdorur thëngjill e laps ka dokumentuar me saktësi akribike figura, ndërtesa, situata, portrete dhe njerëz. Në kushtet në të cilat u realizua ky dokumentim, mungesës së mjeteve bazë për mbijetesë, pikturat e tij të kampeve marrin vlerë të shtuar për informacionin që përcjellin në të sotmen nga një dëshmitar okular.



PËRKUJTIMI

Drane Jakja pas vdekjes, Gjelë Gjokola, Mrikë Gjokola dhe Lekë Pervizi u dekoruan nga Presidenti Meta me titullin e lartë "Për meritat të veçanta civile", në ditën e përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare. Regjimi komunist përdoqi në këtë kamp mbi 5 mijë persona ndërsa brenda tij humbën jetën rreth 300 fëmijë mes viteve 1949-1954.

shfaqjet e sotme të intolerancës, përjashtimit dhe ekstremizmit. Vlerat e demokracisë qëndrojnë në principet themelore të saj si barazia, gjithëpërfshirja, transparencja, dhe kjo e fundit është thelbësore për viktimat e sistemit totalitar",-deklaroi z.Meta. Presidenti vendosi theksin tek hapja e dosjeve, por po ashtu kërkoi prej dhunuesve të diktaturës të kërkonin falje. "Pajtimi, gjithashtu, mund të arrihet duke kërkuar të falur, duke pranuar përgjegjësitë, duke shprehur respekt për të gjitha viktimat e regjimit totalitar dhe duke respektuar ata që luftuan kundër tiranisë dhe shtypjes. Drejtësia për viktimat e regjimit komunist dhe totalitarist është thelbësore. Kërkimi i së vërtetës, hapja e arkivave, procedurat e lustracionit, rehabilitimi, integrimi dhe dëshpërbilimi i tyre janë disa nga mënyrat për t'u shprehur atyre dhe familjarëve të tyre mirëkuptim, simpatinë dhe njohjen e vuajtjeve të tyre", u shpreh kreu i shtetit.

**DREJTESIA
KOMENTET**

Artikulli kritikon reformën në drejtësi dhe rolin e Xhorxh Sorosit

"Washington Times": Vetingu po i jep fuqi të plotë Ramës

"Gjykatat kanë mbetur pa kuorumin e nevojshëm"

Valentina Madani

The Washington Times" kritikon sërish qeverinë shqiptare. Një shkrim tjetër ka pasuar atë për ambasadorin amerikand Donald Lu, për të cilin u tha se ka punuar kundër presidentit Donald Trump dhe ka mbështetur kryeministrin Edi Rama.

Shkrimi i gazetës së njohur për linjën konservatore mban datën e djeshme, ndërsa kësaj radhe i kushtohet reformës në drejtësi dhe vetingut. Sipas The Washington Times' vetingu po zhduk kundërshtarët politikë të Ramës dhe po i jep fuqi absolute duke vendosur pas gjithë kësaj miliarderin George Soros.

Në shkrim thuhet se gjykatës të korruptuar janë mbajtur në detyrë dhe zyrtarë të ndershëm janë larguar nga detyra, nëse ata besojnë gjënë e gabuar ose mbështesin partinë e gabuar. "Në vitet e fundit, Shqipëria është kthyer në një narkoshtet, duke u zhvendosur në krye të listave të prodhimit të marijuanës që trafikohet në Itali dhe në pjesën tjetër të Europës. Drogat e forta janë, gjithashtu, shumë të përhapura", shkruan opinionisti.

Axhenda devijuese e Soros simbolizohet nga prishja e reformës në Shqipëri nga L. Todd Wood - 'The Washington Times' Reforma në drejtësi dukej si një ide e mirë në Shqipëri, e cila, si shumë vende ish-komuniste, po përballlet me pasojat e një trashëgimie dhjetëra vjeçare korrupsioni. Nuk ka hapësirë të mjaftueshme në këtë rubrikë për të hyrë në detajet e ndërlikuara të kësaj reforme, por ndikimi keqdashës i organizatave dhe këshilltarëve të financuar nga miliarderi liberal hungarezo-amerikan George Soros, është i qartë në Shqipëri, ndërsa zyrtarët shqiptarë përpigjen të rishikojnë sistemin gjyqësor. "Procesi i reformës", i cili filloi në vitin 2016, i ndihmuar dhe



Përplasja mes kreut të PS-PD pas shkrimit në median amerikane

Rama: Opozita paguan artikujt nëpër botë. Përgjigjet Basha: Nuk e blen dot popullin

Kryeministri Edi Rama ka reaguar ashpër ndaj opozitës pas disa shkrimeve të botuara online në të përditshmen amerikane "Washington Times". Aty bëhen akuza të forta për mënyrën se si ambasadori amerikan Donald Lu punoi kundër Presidentit Trump për shkak të lidhjeve që kishte me miliarderin George Soros. Në një tjetër shkrim thuhet se vetingu po zhduk kundërshtarët politikë të Edi Ramës në sistemin e drejtësisë dhe po i jep atij fuqi absolute. Sërish në prapaskenë vendoset Soros dhe fondacioni i tij në Shqipëri. Duket se shkrime të tilla i kanë prishur Ramës qetësinë e mbrëmjes në breg të detit në vilën qeveritare të Vlorës. Në një postim në rrjetet sociale kreu i qeverisë thotë se "shkrime të tilla janë të paguara nga opozita



që e akuzon nga dritarja e shtëpisë publike". "Paguani, paguani artikujt nëpër botë kundër vetingut! Shani e mallkoni në sa gjuhë të mundeni reformën në drejtësi! Na akuzoni sa të doni për imoralitet nga dritarja e shtëpisë suaj publike! Ne do ta pastrojmë me rrënjë drejtësinë se s'kemi frikë nga drejtësia e vërtetë #Derinefund!?", -shkruan Rama. I është përgjigjur menjëherë Lulzim Basha akuzës së

mbushur me emërime politike. Askush nuk e di se kur gjykatat do të plotësohen e do të mund të jenë funksionale si një pushtet i pavarur. Kur, në fakt, ky ishte i gjithë thelbi i reformës. Problemi duket se është struktural, që "ekspertët" shtynë popullin shqiptar të besonte. Pas injorimit të shumë paral-

jmërimeve nga shqiptarët me përvojë në sistemin gjyqësor, u krijua një proces i rreptë verifikimi (vetingu) me supozimin se do të garantonte largimin nga sistemi të gjykatësve dhe prokurorëve të korruptuar. Por shumë pak kandidatë ia kanë dalë procesit të vetingut, duke i lënë gjykatat pa kuorumin e nevojshëm dhe të pam-



Qeveria mblidhet në Vlorë

Kryeministri Edi Rama mbledhi ministrat e tij në vilën qeveritare në Vlorë në një takim informal, për të vijuar analizën e performancës së qeverisë "Rama 2" në vitin e saj të parë. Në këtë mbledhje ministrat ishin të vetëm përpara Ramës, pa prezencën e stafeve përkatëse.



undura për të vendosur mbi kushtetutshmërinë e veprimeve të qeverisë mbi ligjet e miratuara.

Sa e favorshme për qeverinë! Procesi i vetingut është përdorur, gjithashtu, për të zhdukur kundërshtarët politikë nga çdo rol në të gjitha pushtetet, duke ruajtur fuqinë absolute të z. Rama. Natyrisht, gjykatës të korruptuar janë mbajtur në detyrë dhe zyrtarë të ndershëm janë larguar nga detyra, nëse ata besojnë gjënë e gabuar ose mbështesin partinë e gabuar. Kur e gjitha kjo kombinohet me ndryshimet kushtetuese të bëra në vitin 2008, të cilat vendosën që ligjvënësit të mos zgjidheshin më drejtpërdrejt, por u zëvendësua me një sistem me listë partie, në thelb populli shqiptar u privua nga e drejta për të zgjedhur. Sërish, e gjitha kjo duket se ka qenë rezultati i dëshiruar gjatë gjithë kohës. Në vitet e fundit, Shqipëria është kthyer në një narkoshtet, duke u zhvendosur në krye të listave të prodhimit të marijuanës që trafikohet në Itali dhe në pjesën tjetër të Europës. Drogat e forta janë, gjithashtu, shumë të përhapura. Varësia dhe problemet e tjera të drogës po bëhen normë në një vend me vetëm 2.5 milionë njerëz, që është duke u stërmunduar. Gjithashtu, Shqipëria është duke u bërë një pikë trafikimi dhe një portë për në Europë për drogat e forta që vijnë nga

Amerika e Jugut dhe Azia Qendrore. Kritikët thonë se ligjet e miratuara në parlament, që nuk janë subjekt i shqyrtimit të një Gjykate Kushtetuese, pasi është jofunksionale, po ndihmojnë në pastrimin e parave të kësaj tregtie droge. Amerikanët dhe evropianët po injorojnë të gjithë këtë situatë, ndoshta për të shmangur pranimin e dështimit të axhendës Soros/ globaliste, e cila pas shumë përpjekjeve për t'u futur, nuk funksionoi në këtë rajon. Ose, ka funksionuar shumë mirë, por rezultati nuk ka qenë ai që duhej për popullin shqiptar. Socializmi nuk është asnjëherë për njerëzit, por gjithmonë për pushtet. Në fund të fundit, ka të bëjë me marrjen e kontrollit në mënyrat që Marks i kuptoi qartë. Z. Soros është duke u përpjekur të kopjojë një shabllon të dështuar majtist në të gjithë Ballkanin, duke promovuar një shoqëri me kufij të hapur, e ngjashme me një Jugosllavi të re dhe sigurisht të kontrolluar nga socialistët.

Bashkimi Evropian i ka dhënë shumë rëndësi natyrës së supozuar antidemokratike të reformës gjyqësore në Poloni dhe Hungari, por ka injoruar situatën shumë më të tmerrshme dhe të pandershme, që po ndodh në Shqipëri. Siç dihet, rrezet e diellit janë gjithmonë dezinfektuesi më i mirë.

Financieri i "Habilajve", dyshimet mbi ekstradimin, u dërgua në Itali ndërsa hetohej në Shqipëri

Prokuroria e Durrësit pushon hetimet për ekstradimin e Nezar Seiti

Organi i akuzës: Konstatuam shkelje, por jo vepër penale

Ekstradimi i Nezar Seiti në Itali në jan ar të këtij viti prodhoi debat të madh politik në Shqipëri, kjo pasi opozita akuzonte mazhorancën se e ekstradoi për të mbyllur dosjen e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, i cili është, gjithashtu, nën hetim në Shqipëri, si pjesë e grupit "Habilaj". Pak kohë më parë institucionet pranuan se i cilësuar si financier i grupit kriminal "Habilaj" u dërgua në Itali në mënyrë të paligjshme. Për këtë çështje, prokuroria e Durrësit çeli një hetim penal që përfshiu të gjitha institucionet e drejtësisë, me qëllim identifikimin e zyrtarëve që shkëlën ligjin duke lejuar ekstradimin e vlonjatit. Pasi gjykata e Katantias mori vendimin për ta liruar Nezar Seitin, të cilin e çoi nën masën e arrestit në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, News24 u interesua pranë prokurorisë së Durrësit dhe mësoi se hetimet për këtë çështje janë pushuar që në fund të qershorit. Në vendimin e pushimit thuhet se: janë konstatuar shkelje të kryera nga institucionet, por janë të një natyre që nuk



VENDEMI

Në vendimin e pushimit thuhet se: janë konstatuar shkelje të kryera nga institucionet, por janë të një natyre që nuk përbëjnë vepër penale. Në dosje vërehet se, parregullsitë e kryera nga zyrtarët e prokurorisë, gjykatës së Tiranës, dhe zyrtarë të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, janë të karakterit që mund të përbëjnë shkak për masa disiplinore, por nuk i ngarkojnë me përgjegjësi penale.

përbëjnë vepër penale. Në dosje vërehet se, parregullsitë e kryera nga zyrtarët e prokurorisë, gjykatës së Tiranës, dhe zyrtarë të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Minis-

trinë e Drejtësisë, janë të karakterit që mund të përbëjnë shkak për masa disiplinore, por nuk i ngarkojnë me përgjegjësi penale. Ky vendim i prokurorisë së Durrësit është miratuar edhe nga gjykata. Tashmë kur kjo

çështja konsiderohet një histori e mbyllur për drejtësinë në vend, me mjaft interes priten vendimet që do të marrin institucionet e drejtësisë në Itali për Nezar Seitin. Prokurorët në Shqipëri kanë afat deri në mes

HETIMI

Pak kohë më parë institucionet pranuan se i cilësuar si financier i grupit kriminal "Habilaj" u dërgua në Itali në mënyrë të paligjshme. Për këtë çështje, prokuroria e Durrësit çeli një hetim penal që përfshiu të gjitha institucionet e drejtësisë, me qëllim identifikimin e zyrtarëve që shkëlën ligjin duke lejuar ekstradimin e vlonjatit.

të tetorit për të vendosur për çështjen e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, ndaj të cilit rëndojnë dyshime për përfshirje në trafik droge në kuadër të grupit kriminal Habilaj. Nezar Seiti u arrestua në tetor të vitit të kaluar në Babicë të Vlorës gjatë një aksioni antidroge, të drejtuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku u sekuestruan 4 tonë kanabis. Por pas 3 muaj qëndrimi në qeli në Shqipëri u ekstradua drejt Italisë në janar të vitit 2018.



Lehtësimi i masës për financiarin e "Habilajve"

Gjykata e Katantias në Itali lehtësoi dy ditë më parë masën e sigurisë nga "arrest me burg" në "arrest shtëpie" për Nezar Seitin. Injohur si financier i grupit të trafikut të drogës drejtuar nga Moisi Habilaj, Seiti prej mesditës së të mërkurës ka lënë ambientet e paraburgimit dhe sipas urdhërimit të gjykatës, ndodhet nën masën e arrestit në shtëpi. Lajmi u konfirmua nga avokati Detar Hysi, i cili nuk sgaroi se përse gjykata e Katantias vendosi të lehtësojë pozitën e të dyshuarit për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal. Mësohet se lirimi është bërë me kërkesë të Seiti, i cili nëpërmjet avokatit mbrojtës ka bindur gjykatën se prokuroria nuk ka prova të mjaftueshme për akuzat e ngritura ndaj tij. Kujtojmë se nga përgjimet e prokurorisë së Katantias, Seiti ka pasur rolin e financiarit të grupit Habilaj dhe kujdeset për blerjen e gomoneve të shpejta. Gjithashtu, sipas përgjimeve, Seiti bënte shpërndarjen e parave mes anëtarëve të bandës. Vendimi për ekstradimin e Seiti-t në Itali, u kundërshtua dhe nga opozita, e cila hodhi akuzat drejt mazhorancës.

"Vendi ynë i pari në botë për përdorim në raport me popullsinë"

"The Economist": 2.5% e shqiptarëve marrin kokainë

Shqipëria zë vendin e parë në botë për konsumimin e kokainës në raport me popullsinë. Kështu ka raportuar media prestigjioze "The Economist". Në raportin e "The Economist" me titull "Pse kartelet po fitojnë" thuhet se lufta ndaj drogës po shkon drejt një krize të re dhe kartelet e dhunshme të drogës luftojnë për një fitim që kap shifrat e 320 miliard dollarëve në vit. Britania, Spanja, Australia dhe Shtetet e Bashkuara janë shtetet që konsumojnë kokainën më së shumti. Por përqindjen më të madhe e mban Shqipëria dhe 2.5% e popullsisë konsumon drogë, duke mbajtur ven-



din e parë, kjo edhe për shkak se është një rrugë e rëndësishme e trafikut të kokainës Afgane, raporton "The Economist". Bëhet me dije se prodhuesit kryesorë janë vendet e Amerikës së Jugut. Kolumbia është në vendin e 34 në renditje për konsum, por është prodhues dhe furnizues i gjysmës së sasisë së kokainës në botë. 1 kg në xhunglat e Kolumbisë shkon

rreth 2200 dollarë, ndërsa në Meksikë arrin 12-16 mijë dollarë. Në Europë shkon 53-55 mijë dollarë 1 kg. Bandat e krimit të organizuara po kërkojnë rrugë të reja transporti, ndërsa volumin e kanë rritur në shumë se kurrë. Gjithashtu edhe linjat dhe rrugët e vjetra të kanabisit po përdoren për transport kokaine, thotë "The Economist".

Policia: Transportoi një sasi lëndë narkotike për ta shitur

Sekuestrohet kanabis në formë çokollate, arrestohet 37-vjeçari në Elbasan

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka finalizuar operacionin e koduar "Bradasheshi", ku është sekuestruar 7 kg lëndë narkotike Cannabis Sativa në formë çokollate në një makinë. Në kuadër të këtij operacioni është arrestuar Artur Gjolena, 37 vjeç, banues në Tiranë si dhe është shpallur në kërkim V.K., 45 vjeç, banuese në Laç për moskallëzim krimi. "Specialistët për Hetimin e Narkotikëve kishin marrë informacion se në aksin rrugor Peqin-Elbasan, ky shtetas po transportonte një sasi lëndë narkotike për ta shitur, ku gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin e tij me targa TR



3692 J, shërbimet e policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 7 kilogramë lëndë narkotike Cannabis Sativa në formë çokollate" thuhet në njoftimin e policisë. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja

e lëndëve narkotike", "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga nenet 283, 291 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Artur Gjolena, dhe për veprën penale "Moskallëzimi i Krimit" të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit V.K..

Ndalohen tre persona, pritet ekspertiza mjeko-ligjore e viktimës

Gjendet i vdekur në banesë 56-vjeçari në Korçë, dyshohet se është vrarë

Motra e Novruz Shytit: U kërcënua dhe dhunua pak orë para se të humbte jetën

KORÇE

Një 56-vjeçar është gjetur i pajetë në banesë të tij në Korçë. Ngjarja ka ndodhur në lagjen numër 8, ku viktimja Novruz Shyti është gjetur i vdekur nga vëllai i tij, i cili ka njoftuar menjëherë policinë. Uniformat blu kanë konstatuar shenja dhune në pjesën e fytyrës dhe në trupin e Fiqit duke përfunduar dëshmitarët se ai është vrarë dhe nuk ka ndërruar jetë për shkak natyral. Nga hetimet paraprake të policisë dyshohet se 56-vjeçari është dhunuar dhe qëlluar me sende të forta duke i shkakuar vdekjen. Të afërmit dhe dëshmitarët thonë se Nevruz Fiqi pak orë



para ngjarjes u konfliktua me një të afërm të quajtur Emiliano Nafizi për motive të dobëta, i cili u shoqërua në polici menjëherë pa ngjarjes. Motra e viktimës, Liza Hoti tregon kërcënimet që iu bënë të vël-

lajt pak para krimit nga fqinji i tij Nafizi. "Kishin bërë më përpara debate për punën e kanoëve. I kishte thënë mos t'i linde aty thasët se binte erë. Ishin sharë dhe ishin goditur dhe i kishte thënë tim vëllai

që ky do ta ketë vdekjen nga unë". Mësohet se 56-vjeçari Nevruz Fiqi e siguronte jetesën duke mbledhur kanoë ndërsa njihet si përdorues alkooli.

Ndërkohë policia dhe prokuroria në Korçë janë në pritje të ekspertizës mjeko-ligjore, që do të përcaktojë shkakun e vdekjes.

Por burime nga policia e Korçës bënë me dije se nga këqyrja paraprake e trupit të viktimës, janë konstatuar gjurmë gjaku dhe hematoma në fytyrë. Në lidhje me këtë ngjarje policia e Korçës ka ndaluar tre persona si autorë të dyshuar të vrasjes së 56-vjeçarit Nevruz Fiqi. Të ndaluarit janë Arben Nazif 56 vjeç, Emiliano Nazif 30 vjeç dhe Edison Nazif 30 vjeç. Policia sqaron se ditën e djeshme rreth orës 16:00, mes viktimës 3 të ndaluarve ka pasur një konflikt për motive të dobëta. Të ndaluarit po merret në pyetje nga policia për të zbardhur ngjarjen. Ende nuk është e sigurt, nëse plagët janë shkakuar gjatë konfliktit me tre të dyshuarit, apo janë pasojë e humbjes së ekuilibrit dhe rrëzimit për tokë të viktimës. Trupi i pajetë i 56-vjeçarit do t'i nënshtrohet ekspertizës mjeko-ligjore, e cila do të kryhet nga një grup mjekësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore, që pritet të mbërrijnë në morgun e Korçës. Ndërkohë grupi hetimor po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.



Trafikonte drogë me avion nga Shqipëria në Itali, arrestohet 34-vjeçari shqiptar

Policia italiane ka vënë në pranga një 34-vjeçar shqiptar, pasi akuzohet për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Bëhet fjalë për shtetasin Feim Lamaj, banues në krahinën e Forlì-Cesena, ndaj të cilit Gjykata e Bolonjës kishte lëshuar një urdhër arresti. I riu u identifikua gjatë operacionit të koduar "Fluturimi i lirisë". Pas verifikimeve të nevojshme, policia italiane bëri të mundur arrestimin e 34-vjeçarit shqiptar. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, policia sekuestroi në cilësinë e provës materiale, dy detektorë GPS, dy telefona celularë, një fletore, shumën prej 1,660.00 euro, një pasaportë dhe një dokument autentik të identitetit që mban të njëjtin emër dhe një emër të ndryshëm, që është përdorur nga Lamaj për të shmangur kontrollin e forcave të policisë. Nga hetimet e mëhershme të publikuara më 4 maj 2018, u zbulua se Lamaj bashkë me disa shqiptarë të tjerë kishin kryer trafikun e drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Sipas mediave italiane, mësohet se grupi trafikonte drogën me avionë të vegjël drejt Italisë.



"Oficeri dhunon një grua", policia i përgjigjet Berishës: Nuk ishte në shërbim

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, bëri një denoncim ditën e djeshme nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ku thuhet se një polic në qytetin e Krutës ka çarë në kokë me pistoletë një grua. Sipas denoncimit publik të ish-kryeministrit ka ardhur edhe reagimi i Policisë së Shtetit. "Në lidhje me statusin e publikuar sot në rrjetet sociale nga deputeti S. Berisha, informojmë se për ngjarjen ku është përfshirë në konflikt një oficer policie pranë Komisarariatit të Policisë Krutë, janë kryer të gjitha veprimet e duhura ligjore. Konflikti ka ndodhur më datë 23.08.2018, rreth orës 17:00, në rrugën "Kala" ku për motive të dobëta, të castit janë konfrontuar fizikisht shtetasit B.T. 66 vjeç, K.T. 31 vjeç (nipi i B.T.) dhe D.T. (mbesa e B.T.) banues në Krutë me shtetasit E.Q. 36 vjeç, punonjës policie dhe A.Q. 41 vjeç, motra e E.Q. Oficeri i Policisë nuk ka qenë në detyrë kur ka ndodhur konflikti. Të gjitha veprimet hetimore mbi ngjarjen e mësipërme janë kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krutë, nën drejtimin e prokurorisë duke filluar procedim penal në gjendje të lirë në ngarkim të shtetasve B.T. dhe K.T. për veprimet penale "Plagosja e lehtë me dashje" në bashkëpunim.

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR TENDER

PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

1.1. **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1

1.2. **Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in economic development, legal reform, vocational education and training, reform of the water sector, rural development, reforms on strengthening of the internal security, and other areas.

1.3. **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified companies to express their interest in providing office equipment such as photocopier, printers, computers etc.,

2. Companies should fulfill the following requirements:

- 2.1 The products should be "brand name" and the company should be an authorized partner for Albania from manufacturer, for selling and supporting the brand(s) products they offer.
- 2.2 The company should be an authorized service provider for the products it will offer.
- 2.3 Provide evidences of brand certified professionals, who will implement the solution

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3. The **due date** for submitting the application is **07.09.2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Procurement of respective equipment for the project "Stärkung der inneren Sicherheit im Westbalkan", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbeg, No. 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancies:

Posts Titles:	1- National Consultant – support to employment of Vulnerable Youth and Women in Northern Albania
	2-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Kukës
	3-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Shkodra
	4-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Dibra
Type of Contract:	Individual Contract

Project: Support to Employment and Social Services for Vulnerable Youth and Women in Northern Albania

Duty Station: Tirana, Albania
Deadline for Application: September 5, 2018
Job Description: <http://al.undp.org>

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToR and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

Ndërtohet skema, dyshohet se drejtuesi i 'Ford'-it hyri në parakalim të gabuar

Ina Allkanjari

Aksident i rëndë në Sarandë, çifti italian me motor përplasjet me një makinë

Humb jetën turistja, bashkëshorti në gjendje të rëndë shëndetësore

SARANDË
Një aksident i rëndë ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në aksin rrugor Sarandë-Ksamil, ku si pasojë një turiste italiane ka humbur jetën ndërsa ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore bashkëshorti i saj. Aksidenti tragjik, i cili ndodhi pranë vendit të njohur si 'Hidrovorit', u ndërpreu pushimet e fundit nga Xhenova në ditën e fundit. Maria Sedda, 64 vjeçe, mbeti viktimë ndërsa në gjendje të rëndë shëndetësore në spitalin e Sarandës ndodhet burri Giuseppe Scitutto, 65 vjeç. Sipas uniformave blu një makinë "Ford" me targa AA 609 UD është përplasur me motorin tip "Piaggio" me targa AL 429 me të cilin udhëtonte çifti italian. Policia shkoi menjëherë në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve dhe motiveve të aksidentit.

NGJARJA
Përgjakën sërish rrugët në Shqipëri, këtë herë viktimat janë shtetas të huaj. Më datë 24.08.2018, rreth orës 11:00, në aksin rrugor Sarandë - Butrint, në fund të Kanalit të Çukës ka ndodhur një aksident midis një automjeti dhe motorit, me pasojë vdekjen e një personi. Konkretisht në zonën e Hidrovorit, automjeti tip "Ford" me targa AA 609 UD është përplasur me një motoçikletë tip "Piaggio" me targa AL 429, ku si pasojë ka humbur jetën një shtetase italiane Maria Sedda (pasagjerja e motorit) dhe është plagosur rëndë drejtuesi i këtij motor bashkëshorti i saj Giuseppe Scitutto, të dy shtetas italian me banim në Genova, Itali. 65-vjeçar



Vendi ku ndodhi aksidenti



KUKES - Një aksident me pasojë plagosjen ka ndodhur mesditën e djeshme në qytetin e Kukësit. Si pasojë e përplasjes së dy automjeteve kanë mbetur të plagosur 4 persona. Sipas policisë, 3 prej tyre janë jashtë rrezikut ndërsa 1 është në gjendje të rëndë shëndetësore. Incidenti ndo-

pasi mori ndihmën mjekësore në spitalin e Sarandës u transportua në Tiranë për mjekim më të specializuar. Mësohet se mjeti tip "Ford" udhëtonte nga Saranda për në Ksamil, ndërsa motori tip "Piaggio"

Përplasen dy makina në Kukës, katër të plagosur, një në gjendje të rëndë

dhi pasi u përplasën një 'Volkswagen Passat' dhe një 'Ford Focus'. Konkretisht mësohet se aksidenti ka ndodhur tek mbikalimi i Gostilit në aksin rrugor Kukës-Bicaj, ku makina tip Ford me targë italiane, CF 756 NM është përplasur me


vinte nga Ksamili në drejtim të Sarandës. Përplasja ka ndodhur në afërsi të kanalit të Çukës, ku dyshohet se 'Ford'i i ka hyrë në parakalim një mjete tjetër, ndërsa përballë i vinte motori. Në momentin

një 'Volksagen' me targë AA682 KE për pasojë të dy makinat kanë përfunduar në bordurat anësore. Personat e aksidentuar janë dërguar në spitalin e Kukësit. Policia shkoi menjëherë në vendngjarje për të zbuluar shkaqet e aksidentit. Edhe

e përplasjes ka dyshime se 'Ford'i ka tentuar të bëjë një manovër, por e ka pasur të pamundur të shmangë përplasjen në krahun e pasagjerit. Gjithashtu, bëhet me dije se makina tip "Ford" është në pronësi të

në Trush të Shkodrës është regjistruar një aksident ku 3 makina janë përplasur me njëra-tjetrën. Bëhet me dije se njëra nga makina ka përfunduar në kanal. Fatmirësisht nga aksidenti ka pasur vetëm dëme materiale.

shtetasit me inicialet A.T, ndërsa motori ku udhëtonte çifti ishte marrë me qira dhe rezultoi në pronësi të J.P. Sakaq grupi hetimor është duke kryer hetimet e mëtejshme në lidhje me sqarimin e rrethanave.



Humbi burrin dhe djalin në aksident në Kanada, gruaja shqiptare bie në koma

KANADA - Një familje shqiptare u përfshi në një aksident tragjik të dielën në Ontario të Kanadasë. Nga ngjarja mbetën të vdekur në vend atë e bir, Fatos Metko, 45 vjeç dhe Fioralb Metko, 14 vjeç si dhe u plagosën e shoqja e 45-vjeçarit, Maralba dhe vajza Brianna. Mësohet se Maralba Metko është në gjendje kritike për jetën dhe ka kaluar në gjendje kome. Ndërkohë, vajza e tyre 9-vjeçare, Brianna, është përmirësuar ndjeshëm fizikisht. Familja shqiptare me origjinë nga Erseka po vizitonte Ontarion pasi planifikonte të zhvendosej aty që të ishte më pranë të afërmeve, të cilët jetojnë në Michigan. Aksidenti ndodhi pasi mjeti i tyre u përplas me një dre e më pas me një automjet që po vinte përballë, vajza e viktimës, Maralba dhe vajza Brianna u dërguan në spital me plagë të rënda. Viktima pati edhe nga automjeti tjetër i përplasur. Nënë e bijë, 51-vjeçarja C. Caraoa dhe vajza nëntëvjeçare A. Karaoja kanë gjetur vdekjen e menjëhershme dhe tre të tjerë janë në spital me lëndime të rënda.

ZJARR NË KODRAT ME ULLISHTE NË LUSHNJË, DIGJEN 10 HEKTARË

Rreth 10 hektarë të mbjella me ullishte, por edhe sipërfaqe me shkurre të larta janë djegur ditën e djeshme në kurorën e gjelbër në Lushnjë. Zjarri i nisur fillimisht në një prej luginave të kodrave të qytetit në afërsi të Kasharajt konsiderohet si aksidental. Edhe pse kanë qenë prezent me urgjencë në vendngjarje, zjarrfikësit e kanë të pamundur të ndërhyjnë për të shuar zjarrin pasi terreni kodrinor nuk i krijon asnjë mundësi të shkojnë me mjetin me ujë. Mësohet se ullishtat e shkruabuara ishin pronë e banorëve të Lushnjës.



FOTOLAJM

SHKURT

Aksidenti tragjik në Fier ku vdiq shtatzëna, lihet në burg drejtuesi i "Benzit"

FIER - Gjykata e Fierit ka dhënë ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për Edmond Asllanin që dyshohet se shkaktoi aksidentin e rëndë në Fier ku humbi jetën një grua shtatzënë dhe u plagosën disa persona të tjerë. Ndërkohë sapo ka lënë gjykatën Asllani ka përhëndetur të afërmit e tij që me sa duket e prisnin jashtë, mes tyre dhe gruaja. "Puthe cunin, mos ki merak", i thotë bashkëshortes Asllani. Ai u arrestua më 21 gusht, pasi në aksin rrugor Fier-Vlorë, duke drejtuar mjetin tip "Benz", është përplasur me mjetin tjetër tip "Benz", me drejtues shtetasin L.T., 32 vjeç, banues në fshatin Sheq Musalalaj dhe me mjetin tip "Audi", me drejtues shtetasin A.T., vjeç 64, banues në fshatin Martin. Si pasojë ka humbur jetën pasagjerja në mjetin tip "Audi", shtetasja M.T., 27 vjeçe, banuese në fshatin Martin si edhe aktualisht ndodhen në spital shtetaset L.T., 7 vjeçe dhe K.T., 41 vjeçe, banuese në fshatin Qarr, pasagjerë në mjetin "Audi" dhe drejtuesi i mjetit "Benz" shtetasi L.T., 32 vjeç dhe i mituri Xh.T., 1 vjeç.

Ornela Manjani

Rritet numri i bizneseve me borxhe, detyrimet e prapambetura do të mbledhen me forcë

Tatimet çojnë 21 mijë biznese në sekuestro

Lista e subjekteve që nuk shlyejnë detyrimet u rrit me 20% në 7 muaj



Mbi 21 mijë, ka shkuar numri i bizneseve ndaj të cilave administrata tatimore ka vendosur barrë hipotekare dhe siguruese për shkak se figurojnë debitorë ndaj fiskut. Lista e gjatë është bërë publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dhe në të figurojnë subjekte tregtare nga të gjitha qytetet e vendit. Barrë hipotekare dhe siguruese, është fillimi i procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimeve. Në krahasim me fillim vitin lista është shtuar me mbi 4300 subjekte. Njoftimi i tatimeve bëhet që personat e tretë të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe që organet apo institucionet, të cilët kanë bërë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesve debitorë, të regjistrojnë detyrimin tatimor të paguar si barrë mbi këtë pasuri dhe të mos lejojnë kryerjen e transaksioneve për transferimin e pasurive të tatimpaguesve debitorë, deri në momentin që detyrimi tatimor i paguarar të arkëtohet. Me pagimin e plotë të detyrimit, të dhënat e subjektit fshihen nga lista e debitorëve.

BIZNESET

Lista me tatimpaguesit, që kanë krijuar borxhe në tatime dhe ndaj tyre është vënë barra hipotekare për mbledhjen e detyrimeve me forcë, u zgjerua me 20 përqind gjatë 7 muajve. Sipas të dhënave të tatimeve të azhuruara deri në fund të gushtit shihet se numri i bizneseve me barrë hipotekare shkoj në 21,185 ose 4,335 biznese më shumë se fillimi i vitit.

BORXHI TATIMOR

Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Tatimeve, detyrimi aktual i subjekteve me barrë hipotekare, që bizneset i kanë shtetit, është 78 miliardë lekë. Peshën më të madhe në vlerën e detyrimeve e zënë subjektet e Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, 38%, më pas vjen Drejtoria e Tiranës, e cila, në fakt, ka

një numër absolutisht më të madh të tatimpaguesve, me 35,6%. Durrësi rreth 5%. Sipas të dhënave të fundit të Tatimeve, nga procesi aktual i fshirjes së detyrimeve të prapambetura, janë 14,6 miliardë lekë detyrime të prapambetura e të falura, të krijuara para vitit 2010 (sipas ligjit të faljes, detyrimet deri në vitin 2010 fshihen pa kushte 100%), ku rreth 37% e tyre janë administruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranës (shiko në vijim intervistën e plotë të Tatimeve).

PAGESA E BORXHIT ME KËSTE

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka më shumë se një vit që u bën thirrje bizneseve të shlyejnë detyrimet me këste. Tatimet njoftojnë tatimpaguesit për kushtet dhe detyrimet për të cilat lidhet marrëveshja me këste dhe afati i zgjatjes së kësaj marrëveshjeje. Tatimpaguesi, duke justifikuar paafësinë likuiduese të përkohshme financiare, mund të paguajë me këste një detyrim tatimor të paguarar. Marrëveshja me këste nuk mund të zgjatet përtej fundit të vitit që pason vitin në të cilin është lidhur ajo. Në rastet e marrëveshjeve për pagesë me këste, tatimpaguesi paguan kamatëvonesat, por nuk llogaritet gjohë për pagesë të vonuar. Marrëveshja për pagesë me këste nuk mund të lidhet për detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

TRE HAPAT PËR TË LIDHUR MARRËVESHJEN

Hapi I: Kërkesë me shkrim drejtuar drejtorisë rajonale tatimore nën juridiksionin e së cilës është regjistruar. (Shpjego rrethanat dhe arsyet pse kërkohet të lidhet një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet tatimore.)

Hapi II: Drejtoria Rajonale Tatimore brenda 10 ditëve njofton nëse kërkesa pranohet apo refuzohet.

Hapi III: Nëse kërkesa pranohet, nënshkruhet marrëveshja për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të paguarara. Kjo marrëveshje nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve ose drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, vetëm nëse tatimpaguesi paguan menjëherë 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja e pagesës me këste.

a. Administrata Tatimore ndërpret masat e mbledhjes me forcë, të mbledhjes së detyrimeve tatimore, por ajo nuk tërheq masën e vendosur për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor.

b. Nënshkrimi i një marrëveshjeje për pagesën me këste të një detyrimi tatimor, nuk ndërpret llogaritjen e kamatëvonesave për mospagim në afat të detyrimit tatimor të mbetur paguarar.

c. Tatimpaguesi, ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, qoftë në formën e barrës së sigurisë apo barrës hipotekare, në rastet kur pretendohet se zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Hapja e bizneseve, rritet mbështetja me kredi bankare

Kredia e sistemit bankar për hapjen e bizneseve të reja është rritur ndjeshëm gjatë gjysmës së parë të këtij viti. Mbështetur në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, në fund të qershorit, totali i kredisë për hapje biznesesh të reja arriti në 5.9 miliardë lekë, në rritje me afro 16% krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Zgjerimi i këtij produkti ka sjellë edhe rritje të peshës specifike në portofolet e sistemit bankar. Nga 1.3% që zinte vitin e kaluar, tashmë kredia për hapje biznesi zë 1.8% të totalit të kredisë për sipërmarrjen. Peshë e këtij produkti ngelet sidoqoftë e ulët, sepse zakonisht bankat janë konservatore në financimin e projekteve për biznese të reja. Arsyeja kryesore është mungesa e një historiku që mundëson vlerësimin e kredimarrësit dhe të projektit. Megjithatë, në rastet e sipërmarrjeve që mund të kenë përvojë vepimtarie në sektorë të tjerë dhe zotërojnë një kolateral të pranueshëm, bankat mund edhe të financojnë nisjen e një aktiviteti të ri. Në çdo rast, kjo bëhet duke ndarë rrezikun e investimit me kredimarrësin, çka do të thotë se bankat nuk e financojnë në masën 100% projektin e ngritjes së një biznesi. Sidoqoftë, rritja e kredisë bankare për çdo hapje biznesi dëshmon sidoqoftë një qasje më pozitive të sistemit bankar ndaj projekteve të reja të sipërmarrjes. Kredia për hapje biznesi jepet kryesisht në lekë dhe portofoli në monedhë vendase përbën 76% të totalit për këtë produkt. Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në pesë muajt e parë të këtij viti në Shqipëri janë hapur rreth 9400 biznese të reja.

BALANCIMI I ENERGJISË

Rreth 575 mijë euro i ka kushtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbulimi i humbjeve në rrjet për muajin gusht. Shuma totale i takon rezultateve zyrtare të tenderit, të publikuar nga OST për 4 javët e fundit e më konkretisht nga data 30 korrik, deri në datën 26 gusht. Vlerën më të madhe e ka përfituar Korporata Elektroenergetike Shqiptare, ndërkohë që përfitues janë edhe disa nga op-



eratorët e tjerë të regjistruar si palë ofruese e shërbimeve balancuese. Sipas rregullores në fuqi, pjesëmarrësit e tregut që veprojnë si ofrues të shërbimeve të balancimit ose palë përgjegjëse për balancim, duhet të paguajnë ose të pranojnë pagesat që rezultojnë nga përllogaritjet e mekanizmit balancues. Ndërkohë që, është përgjegjësi e OST-së të mirëmbajë sistemin në balancim. Sistemi i OST konsiderohet në disbalanc kur OST ka tepricë apo mungesë të en-

Për gushtin, OST paguan 575 mijë euro për mbulimin e humbjeve në rrjet

ergjisë elektrike dhe është pikërisht ai që ndërmerr masat që sistemi të operojë në balancë. Këto masa mund të përfshijnë rregullimin për ulje, përfshirë: uljen e prodhimit të gjeneratorit ose uljen e konsumit apo shkëmbimin e balancimit ndërkufitar kur sistemi ka mungesa apo është i shkurtër. Disbalancat llogariten nga OST për çdo periudhë llogaritëse, për çdo palë përgjegjëse të balancimit.

parashikon rregullimin për ngritje, përfshirë: ngritjen e prodhimit të gjeneratorit ose uljen e konsumit apo shkëmbimin e balancimit ndërkufitar kur sistemi ka mungesa apo është i shkurtër. Disbalancat llogariten nga OST për çdo periudhë llogaritëse, për çdo palë përgjegjëse të balancimit.

Shqipëria gjithnjë e më shumë po behet atraktive për të huajt të cilët kanë rritur preferencat për të kaluar pushime në Shqipëri. Çmimet ende të lira të kombinuara me një varietet mundësie për turizmin e detit dhe aventurës po tërheqin vizitorë. Sipas INSTAT numri i të huajve të që u futën në Shqipëri në korrik u rrit me 19 për qind, teksa për të gjithë 7 mujorin rritja është, gjithashtu, dyshifrore me 12 %. Sipas të dhënave të INSTAT, në 7 muajt e parë të vitit, në Shqipëri hynë gjithsej 2,9 milionë shtetas të huaj, me një rritje prej 12.4 % në krahasim me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Rritja e më të madhe shihet të ke turistët polakë, me 33

Pushuesit nga Perëndimi dhe Kosova në rritje

Të huajt që vizitojnë Shqipërinë, 12% më shumë në janar-korrik

IKIN DHE SHQIPTARËT

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit korrik 2018 është 465.626. Krahasuar me korrik 2017, ky numër është ulur 6,2 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit korrik 2018 është 970.178.

për qind, por numrin më të madh në raport me totalin e kanë vizitorët nga Kosova, të cilët janë vënë në një trend rritës pas rënies së vitit të kaluar. Nga të dhënat e 7 mujorit shihet se numri i

vizitoreve nga Kosova arriti në 911.631 mijë me një rritje 5,3 për qind në krahasim me një vit më parë. Vetëm në korrik vizitorët nga ana tjetër e kombit u rritën me 16,3 %. Në vend të dytë janë maqedonasi,

me 381 mijë hyrje për 5 mujorin, me rritje 11.7 me bazë vjetore. Pas tyre vijjnë grekët me 275 mijë hyrje (rritje 12.1%), Malazezët me 203 mijë persona (+4.7%) italianët me 200 mijë persona me një rritje 10 %. Rritjen më të lartë, ndonëse duke u nisur nga një bazë e vogël, e kanë shënuar polakët me 33% dhe gjermanët me 18,1 %. Polakët "zbuluan" vitin e kaluar Shqipërinë, përmes agjencisë së të madhe polake iTAKA dhe prenotimet



e tyre rezultojnë në rritje këtë vit. Sipas statistikave të INSTAT, për 7 muajt e parë të vitit mbi 78 mijë polakë, ose 33 % në krahasim me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Në rritje ishte edhe numri i gjermanëve, me 74 mijë hyrje, me rritje vjetore prej 11,9%. Nga 1 qershori, hotelet, sidomos ato në zonën e Golemit në Durrës kanë raportuar se kanë qenë 100% të prenotuara, ndaj numri i turistëve pritet në rritje. Një fluks i lartë ka ardhur nga vendet nordike, por INSTAT nuk i raporton të ndara Norvegjinë, Suedinë etj.

Autoriteti njofton qytetarët, që nuk kanë marrë paratë për dëme, të depozitojnë kërkesat

Dëmet në aksidente, AMF: Silni ankesat kur nuk paguheni

Stafi do të ndjekë dosjen dhe do të adresojë zgjidhjen

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) i ka kërkuar në vazhdimësi Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) shpërndarjen e dosjeve për praktikantë e miratuara, të papaguara, të cilat kanë vendim gjyqësor të formës së prerë, objekt i Fondit të Kompensimit. Autoriteti njofton qytetarët që kanë problematika lidhur me dëme të prapambetura nga Fondi i Kompensimit të komunikojmë me BSHS-së. Stafi i Byrosë do t'i informojë dhe orientojë ata për shoqërinë e sigurimit tek e cila është deleguar praktika për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit të tyre. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, lista e dosjeve nuk publikohet, por qytetarët e interesuar mund ta gjejnë informacionin e detajuar pranë BSHS. "Për çdo problematikë apo për më shumë sqarime në lidhje me këtë proces, çdo qytetar mund të komunikojë me email konsumatori@amf.gov.al, amf@amf.gov.al ose mund të paraqitet pranë zyrave të AMF-së. AMF mbetet e anghazhuar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre në treg. Sikurse ka vepruar përmes shumë vendimeve të marra gjatë viteve 2017-2018, AMF vazhdon t'i kushtojë vëmendje mbrojtjes së interesave të qytetarëve. Autoriteti i kërkon bashkëpunimin e qytetarëve që ata të kontaktojnë me AMF për çdo problematikë lidhur me tregjet nën mbikëqyrje"-thuhet në njoftimin e AMF-së.

VLERËSIMET
Sipas vlerësimeve masa e Fondit të Kompensimit për detyrimet e mbartura dhe që



do të lindin për vitin 2018 vlerësohet rreth 1.8 miliardë lekë, e ndarë: 1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë; 418 milion lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe jo më pak se 150 milionë lekë për

ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018. Bordi i AMF-së ka urdhëruar Byrosën Shqiptare të Sigurimit që të ndjekë procedurën e shlyerjes së menjëhershme të detyrimeve të papaguara të praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për të cilat ka përfunduar procesin e trajtimit (përmbarimorë, me vendim gjykate të formës së prerë dhe të miratuara, por të papaguara) në vlerën totale 923 354 758 lekë për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në

31.12.2017.

BORXHI I RI
Njëkohësisht, për të mos krijuar borxh të ri, Bordi i AMF-së vendosi pak kohë më parë krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2018, minimalisht në masën 895 203 094 lekë, i ndarë: 745 203 094 lekë për shlyerjen e detyrimeve për ngjarjet nga 1 janar 2001 deri në 31 dhjetor 2017 (që janë në proces trajtimi apo procese gjyqësore, pa vendim të formës së prerë) dhe jo më pak se 150 milion lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018. Vendimi bën të mundur që çdo qytetar që gjatë vitit 2018 fiton një vendim të formës së prerë nga gjykatat ose i miratohet nga shoqëritë e sigurimit, do të paguhet brenda vitit 2018. Autoriteti, ashtu si në shumë vendime të marra gjatë vitit 2017, do të vazhdojë të fokusohet tek mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe e konsideron shlyerjen e detyrimeve të Fondit të Kompensimit si një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2018, edhe pse këto detyrime kanë filluar të mbartën prej vitit 2001.

Ndryshimet ligjore

Lehtësitë për agroturizmin hyjnë në fuqi më 1 janar

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën me dije tatimpaguesit, se në Fletoren Zyrtare nr. 111, janë publikuar ndryshimet, në ligji nr. 40/2018 datë 9.7.2018, për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Ndryshimet ligjore, që pritet të hyjnë në fuqi në datë 1 janar 2019 synojnë incentivimin dhe zhvillimin e veprimtarive pritëse të certifikuara si "agroturizëm". Më konkretisht nenit 49, i shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: "Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6% për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6%, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm". Këto ndryshime, vijjnë në vazhdim e lehtësive fiskale që po ndërmerr qeveria shqiptare, për tërheqjen e investimeve të brendshme dhe të huaja, por edhe për t'i dhënë më shumë frymë-marrje, një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, siç është turizmi.



EPSA SHOQËRIA PËRMARBUJËSE PRIVATE "E.P.S.A." SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1. "Pjll + Kullote" me sip. 280.000 m². Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Porot, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.360.224 Euro. Ankandi zhvillohet datë 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr:"1. Qemall", Pall,"Fratarit", K.6.Tiranë.

2. "Pjll + Kullote" me sip. 95.000 m². Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Porot, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 1.140.076 Euro. Ankandi zhvillohet datë 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr:"1. Qemall", Pall,"Fratarit", K.6.Tiranë.

Per çdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 14.09.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shlyerjen e pasurisë të paluajtshme Thullë me sipërfaqe 24.405.50 m² e ndodhur në rrugën "Ali Shëfqeti", Tiranë me Nr.pasurie 9/609, Volumi 20, Faqe 6, në pronësi të Shoqërisë BAU- CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 307.509 (Treqind e shtatë mijë e pesëqind e nente) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Falë punës investive nga Bashkia e Tiranës, zona përreth rrugës "Njazi Meka" në Njësinë nr.4 është shndërruar në një bllok që ofron jo vetëm çerdhe, kopshte, shkolla e mensa sociale, por edhe një mobilim urban nga më të mirët në kryeqytet. Ndërkohë janë drejt fundit punimet për rikualifikimin urban të të gjithë kësaj lagje që shtrihet në një sipërfaqe prej 58 hektarësh dhe ku përfshihen 35 segmente rrugore dhe sheshe. Kryebashkiaku, Erion Veliaj, i shoqëruar nga deputeti, Sadri Abazi, inspektor dje punimet që po kryhen, ndërsa theksoi se ndryshimi në këtë pjesë të Tiranës është i madh. "Jemi sërish në njësinë 4, një një-

Veliaj: Transformimi i zonës, premtim i mbajtur

Rehabilitohet blloku i banimit nga Alliasi deri në Bregun e Lumit

INVESTIMI

"Sot kemi prekur 5 blloqe masive, 32 rrugë. Ka plot të tjera për të bërë, por më vjen mirë që e kemi mbajtur këtë premtim, ende pa mbaruar mandatin në Bashki. Kemi qenë këtu dhe e kemi premtuar këtë bllok në fushatë dhe pas 3 vitesh, lagjia nuk dallohet më", -u shpreh kryebashkiaku.

si, e cila për faktin që ishte pjesë e Bregut të Lumit, për faktin që kishte shumë zona informale, konsiderohej një llaflaf i pistë në Tiranë. Sot e kemi ndryshuar këtë realitet.

Bregu i Lumit jo vetëm është sinonim i shkollave, kopshteve, çerdheve të reja, por i shumë prej blloqeve që po transformohen dhe mesazhi që duam të japim, nuk ka

rëndësi nëse je kuksian, apo nëse je sarandiot; nëse je di-bran apo përmetar. Kush jeton në Tiranë do trajtohet si kryeqytetas", -tha Veliaj. Ky i fundit shtoi se ky rehabilitim i zonës është një premtim i mbajtur dhe se tashmë me këtë investim kuptimi negativ i emërimit "Bregu i Lumit" nuk vlen më. "Më vjen mirë sot që një lagje, e cila ka banorë që në 30 vitet e fundit kanë ardhur për të kërkuar një jetë më të mirë në Tiranë, realisht kanë mar-



Kryebashkiaku, Erion Veliaj gjatë inspektimit të punimeve

rë jetën që kanë kërkuar. Pra, duke vënë këtë infrastrukturë, me rrugët, me trotualet për fëmijët, me ndriçimin, me ujësjellësin e gjithë kanalizimet, kemi sjellë realisht të njëjtin standard tek Bregu i Lumit, që është edhe në lagjet e tjera të Tiranës. Sigurisht që ka ende shumë punë për të bërë. Sot kemi

prekur 5 blloqe masive, 32 rrugë. Ka plot të tjera për të bërë, por më vjen mirë që e kemi mbajtur këtë premtim, ende pa mbaruar mandatin në Bashki. Kemi qenë këtu dhe e kemi premtuar këtë bllok në fushatë dhe pas 3 vitesh, lagjia nuk dallohet më", -u shpreh kryebashkiaku.

"Do e transportojmë me traget drejt Italisë, nuk do të ketë mjek që ta mbikëqyrë rrugës"

Voltiza Duro

Prej 8 muajsh, ai po lufton fort me armikun që nuk e mendonte kurrë se do të pushtonte trupin e tij. Djaloshi 19 vjeçar quhet Ronaldo Kasaj e tashmë gjendja e tij shëndetësore është mjaft kritike pasi tumori po e mposht dita-ditës. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Shëdmin Kasaj, babai i të riut tregon se përkeqësimi i situatës erdhi si pasojë e mungesës së medikamenteve në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Prindërit kanë vendosur që ta çojnë Ronaldon për një trajtim të specializuar në Itali, por transporti i 19-vjeçarit do të bëhet me traget, e madje pa asnjë mjek apo infermier që të mbikëqyrë gjendjen e tij. Më tej, Kasaj me zërin që i dridhet e sytë plot me lot, i bën thirrje institucioneve përkatëse e gjithë shqiptarëve që të ndihmojnë sadopak në shpëtimin e Ronaldos nga vdekja, pasi nuk mundën t'i përballojnë vetë shpenzimet e trajtimit në Itali.

Para sa kohësh është konstatuar se djali juaj vuan nga një sëmundje tumorale?

Prej 7 muajsh djali im 19 vjeçar, Ronaldo u diagnostikua nga një gjëndër tumorale në pjesën e grykës. Mjekët pasi i bënë vizitat e diagnostikimet që i duheshin djalit, na thanë që vuan nga Limfoma Malinjë, në stadin e parë.

Në cilin spital është trajtuar 19 vjeçari deri më tani?

Pas diagnostikimit, spitali Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" e mori përsipër trajtimin dhe kurimin e tim biri. Kishim shumë muaj që po luftonim me këtë sëmundje e madje po prisnim që të përmirësohej, por djali filloi të shfaqte enjtje të pjesa e qafës dhe i kërkuam shpjegim doktorit se pse arriti gjendja shëndetësore e Ronaldos në këtë pikë. Po

Thirrja e dëshpëruar e babait: Na ndihmoni, tumori po na merr djalin 19 vjeç

Shëdmin Kasaj: Doktor i Onkologjikut tha se spitali s'ka ilaçe



19 vjeçari Ronaldo Kasaj

Djaloshi Ronaldo Kasaj i lindur më 07.11.1998, me Nr. 9 kartele, diagnostikohet me limfomë Non Hodgkin Stadi A. Biopsia me Nr. 201/18: Limfoma Malinjë Non Hodgkin me qeliza B, nëntipi Burkitt. Tumori është paraqitur në Spitalin Onkologjik më datë 27.01.2018 me Adenopatitë cervikale të majtë me përmasa rreth 6-7 cm. Pa shqetësime të tjera. Torako-Abdominal ishte normal. Aminimet e Gjaktit Periferik, Analizat Biokimike, HIV, HCV, CMV rezultuan negative. Biopsia e Adenopatisë Cervikale e cila rezultoi LMNH. Rezultati i IHC: CD 45+, CD 10+, CD 20+, BCL2+, BCL6+, Ki 67= 90%. Sori u trajtua me katër (4) cikle me skemën R-CHOP (rituximab + cyclofosfam + doxorubicine + prednizon) çdo 21 ditë dhe më pas u trajtua me RadioTerapië Cervikale të majtë me dozën 44 Gy. Rezultati i IHC: CD 45+, CD 10+, CD 20+, BCL2+, BCL6+, Ki 67= 90%. Faksimille e epikrizës së të sëmurit.

APELI

"Jemi dy prindër të tronditur, me zemër të copëtuar që kërkojmë vetëm që drita e syve tonë të mos shuhet, por të jetojë jetën. Fatkeqësisht mundësitë tona ekonomike janë zero, jemi copë-copë e nuk e përballojmë dot trajtimin me të ardhurat që kemi. Ju lutem, i jepni një mundësi Ronaldos që të jetojë!", -bën thirrje babai i Ronaldos.

shikoj se gjendja sa vjen e përkeqësohet edhe më shumë.

Sipas mjekëve të Onkologjikut, pse shkoi drejt përkeqësimit gjendja shëndetësore e djalit tuaj?

Mjeku që kishte marrë sipër trajtimin e djalit më tha se nuk ka ilaçe për kurimin e tij, e madje ngriti duart lart sikur u dorëzua para mungesës së medikamenteve. Ronaldo nuk ishte i shtruar në spital, thjesht e çonim te "Nënë Tereza" për të bërë kimioterapitë një herë në 21 ditë. Pas trajtimit të fundit, kur shkuan në Vlorë, pësoi një enjtje të tmerrshme dhe nuk e dinim se nga i vinte e gjithë kjo. Askush nuk po na shpjegon

asgjë! Jemi në mëshirë të fatit e i kemi sytë e duart vetëm nga Zoti që të bëjë një mrekulli për djalin e ta shpëtojë nga vdekja. Flitet kaq shumë për shëndetësinë falas, në një kohë që im bir është lënë në këtë gjendje dhe po e shikojmë të na shuhet ditë pas dite, e kjo për shkak të mungesës së ilaçeve që e pohojnë edhe vetë mjekët me gojën e tyre. Në datën 15 gusht isha te Onkologjiku dhe pyeta doktorin nëse djali do e bënte kimioterapinë të rregullt, por mjeku tha që mungonte një ilaç. Nuk kam ku ta gjej këtë

Çfarë do të bëni për të shpëtuar Ronaldon nga sëmundja?

Do të nisem drejt Italisë urgjentisht me traget së bashku me Ronaldon, është rruga e vetme që më ka ngulur për ta shpëtuar, pavarësisht se nuk kemi para për ta trajtuar jashtë.

A do iu shoqërojë një mjek apo infermier gjatë rrugës për Itali, në mënyrë që djali të jetë nën mbikëqyrje dhe të mos shfaqë komplikacione?

Kërkova ndihmë nga shteti për ta transportuar për në Itali djalin, në mënyrë që të jetë nën kujdesin e mjekëve, por doktori më tha që për këto lloj sëmundjesh nuk mund të vijë stafi mjekësor gjatë rrugës nga Shqipëria në Itali. Doktorin më tha ik, e më shuafti të gjitha shpresat



Mbyllet thertorja në Librazhd, tregonte mish me vulë false

Po vijojnë intensivisht kontrollat për disiplinimin e thertoreve dhe të tregimit të produkteve shtazore në funksion të sigurisë ushqimore. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka konstatuar një subjekt, i cili tregonte mish pa vulë dhe certifikatë veterinarë. Trupa inspektuese e DRAKU Elbasan gjatë kontrollit të ushtruar në subjektin "ER" konstatoi 71 kg mish me prejardhje nga kafshë të parregjistruara, të paidentifikuara si dhe pa iu nënshtruar asnjë kontrolli të domosdoshëm veterinar para dhe pas thërjes. Subjekti kishte falsifikuar vulën veterinarë për të shmangur kontrollin e mundshme të AKU-së. Kjo e fundit, vendosi masë administrative 200 mijë lekë, bllokim të menjëhershëm të aktivitetit si dhe konfiskim i 71 kg mish. Po ashtu, u denoncua në organet kompetente për veprën penale të klasifikimit si dhe tregimit të produkteve ushqimore të rrezikshme.

BURSAT NE ITALI APLIKIMI

Voltiza Duro

Studentët e Universtit të Tiranës kanë afat deri më 2 nëntor të këtij viti për të aplikuar për bursë studimi për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019. Ky është njoftimi i publikuar në faqen zyrtare të këtij universiteti ku bëhet thirrje për aplikim. Në kuadër të programit Erasmus +, të interesuarit që plotësojnë kriteret mund të përfitojnë 3 muaj studime në Universitetin Tuscia të Italisë për nivelet e mobilitetit Bachelor apo Master. Bursat do të përfshijnë kompensimin mujor në vlerën 850 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandidatët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi dhe ndërkohë do të vazhdojnë të shlyejnë tarifën në universitetin e vendit të tyre. Këto bursa synojnë shkëmbimin e studentëve përgjatë një semestri studimi në nivelin Bachelor apo Master. Disa nga degët ku mund të aplikoni për ciklin e parë të studimeve Bachelor janë: Gjuhët e kulturës së lartë moderne; Ekonomia e Biznesit; Inxhinieri Industriale; Shkenca Politike; Komunikimi, Teknologjia e Kultura dixhitale; Shkenca Biologjike etj. Ndërsa në nivelin master studentët kanë mundësi të aplikojnë në këto programe studimi: Komunikimi Publik, politik dhe institucional; Marketing; Administrim, financim dhe kontroll; Inxhinieri Mekanike; Filologji Moderne; Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit; Biologji Qelizore e Molekulare etj. Kandidatët e interesuar për bursa në nivelin Bachelor duhet të dorëzojnë këto dokumente pranë Rektoratit të UT-së: kurrikulumin (CV) në gjuhën angleze apo italiane, kopjen e pasaportës, vërtetimin e studentit, listën e notave, dëshminë e mbrojtjes së gjuhës angleze apo italiane në nivelin B1, një letër motivimi si dhe dokumentin "Learnig Agreement". Ndërsa aplikantët për bursa në nivelin Master, bashkangjitur me dokumentet e sipërpërmendura duhet të dorëzojnë edhe diplomën e listën e notave për ciklin Bachelor si dhe listën e notave të nivelit Master të përkthyer në gjuhën zyrtare anglisht apo italisht.

APLIKIMI

Dokumenti Learning

Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 2 nëntorit të këtij viti

Bursa në Itali për studentët e Universitetit të Tiranës, kriteret për kandidatët

Cilat janë degët ku mund të aplikoni, kompensimi mujor



850

EURO KOMPENSIM MUJOR

Bursat do të përfshijnë kompensimin mujor në vlerën 850 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandidatët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi.

2

NËNTOR, AFATI I FUNDIT

Studentët e Universitetit të Tiranës kanë afat deri më 2 nëntor të këtij viti për të aplikuar për bursë studimi për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019. Të interesuarit që plotësojnë kriteret mund të përfitojnë 3 muaj studime në Universitetin Tuscia të Italisë.

TARIFAT

Bursat do të përfshijnë kompensimin mujor në vlerën 850 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandidatët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi dhe ndërkohë do të vazhdojnë të shlyejnë tarifën në universitetin e vendit të tyre.

fakultetin në Shqipëri, e në këtë mënyrë lëndët dhe kreditet do të njihen nga institucioni arsimor i origjinës. I gjithë dokumentacioni për aplikim për bursa studimi duhet të dorëzohet dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit si dhe të skanuara përmes postës elektronike. Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Elton Skendaj.

BURSAT DHE DOKUMENTACIONI

Bursat përfshijnë:

- ◆ Kompensimin mujor (850 euro në muaj për studentët);
- ◆ Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)
- Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:
- ◆ CV (në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- ◆ Kopje e Pasaportës;
- ◆ Vërtetim studentit;
- ◆ Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- ◆ Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;
- ◆ Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B1);
- ◆ *Learning Agreement;

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- ◆ CV (në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- ◆ Kopje e Pasaportës;
- ◆ Vërtetim studentit;
- ◆ Listë notash e nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- ◆ Listë notash dhe diplomë e nivelit Bachelor (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- ◆ Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;
- ◆ Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B1);
- ◆ *Learning Agreement;

*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Tuscia lëndët të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.

* Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Elton Skendaj.

LIBRI

INSTAT: 1 milion shqiptarë nuk lexojnë, drejtoresha e librit: Konkluzione pa krahasime

Fatmira Nikolli

Takohehi për një libër. Ky është titulli që mban fushata e nisur nga Ministria e Kulturës për të nxitur leximin. Në cepa të Tiranës e nëpër rrethe, projekte të ndryshme kanë marrë jetë nën dëshirën e qëllimin e nxitjes së interesit të leximit. Nëse anketa është e qartë, a ka dështuar fushata dyvjeçare? Nuk ka një përgjigje, veçse rezultatet e përcjella nga INSTAT nuk duket se kanë surprizuar gjithaq në mos për shifrën e frikshme 1 milion. Në një shokëri që e ka orientuar veten te konsumi e jo te cilësia, nuk ka se si të jetë surprizë që 1 milion shqiptarë nuk kanë lexuar asnjë libër. Edhe në takimet për të lexuar një libër, jo më shumë se një grusht merrnin pjesë, aq sa duket se nisma që krijuar për fotografi rrjetesh sociale. Megjithatë, përpjekjet janë për t'u vlerësuar edhe pse duket e vështirë t'ua matësh ndikimin në publik. Nëse kemi parasysh që "numri i frekuentimeve në Bibliotekën Kombëtare zbriti në 88 mijë, nga mbi 150 mijë që kishte qenë në vitin 2016", çdo gjë duket e mundur, si zjarr e përmbytja në bibliotekë edhe një anketë që përmbyl propogandën s'ka si të duket e habitshme. Po mbjellim ç'është korrur, një shoqëri që jeton për t'u dukur në nëpër rrjete sociale po sheh në pasqyrë se projektimi i vet ka qenë i rremë. "Takohehi për një libër", një fushatë për të nxitur leximin te njerëzit. Leximi duhet të kalojë nga kënaqësia, si një kënaqësi e përbashkët" thoshte ministria Kumbaro megjithëse botuesit kanë 5 vite që i përkojnë uljen e TVSh-së për librin.

ANKETA

Sipas të dhënave të INSTAT, të nxjerra në një anketë të posaçme shihet se vitin e kaluar mbi 1 milion shqiptarë nuk kanë arritur të lexojnë asnjë libër. Kur "Monitori" publikoi lajmin me të dhënat, shtoi se tekta pjesa tjetër mësohet se ka lexuar shumë pak, rreth 320 mijë shqiptarë të moshës mbi 25 vjeç raportuan se nuk kanë lexuar më pak se 5 libra vitin e kaluar. Teksa pjesa e tyre që kanë lexuar më shumë se kaq sa vjen e zvogëlohet. Rreth 102 mijë shqiptarë raportojnë se kanë lexuar 5-10 libra gjatë vitit të kaluar, ndërsa rreth 44 mijë shqiptarë kanë lexuar më shumë se 10 libra gjatë vitit të kaluar.

Gjithashtu, leximi i gazetave vijon të jetë i kufizuar. Vetëm 583 mijë raportuan se lexojnë gazeta çdo ditë, duke përfshirë edhe leximet online. Ndërsa një pjesë e madhe e shqiptarëve, 213 mijë raportuan se lexojnë lajme njëherë në muaj dhe më rrallë se kaq lexojnë 127 mijë shqiptarë. Sipas të dhënave statistikore të kulturës nga INSTAT, numri i frekuentimeve në bibliotekën më të rëndësishme në vend pothuajse është përgjysmuar gjatë vitit 2017. Numri i frekuentimeve në Bibliotekën Kombëtare zbriti në 88 mijë, nga mbi 150 mijë që kishte qenë në vitin 2016. Ndërsa Eurostat raporton se në BE, banorët shpenzojnë mesatarisht 200 euro për frymë për libra, ndërsa rreth 20 % e popullsisë janë lexues të rregullt të librave. Sipas "Monitorit" në vendet perëndimore, rënia do të ishte tregues i sjelljes elektronike, që do të thotë se pirren që të lexojnë në web më tepër se sa libra fizik, pra e-libra. Por, në rastin shqiptar e-libri nuk është shumë i pranishëm sepse, sipas përfaqësuesve të shtëpive kryesore, pirateria dhe aksesit i pakët në faqe si Amazon, janë penguesit kryesorë.

Por, pas publikimit të anketës ka reaguar Drejtoresha e librit në Ministrinë e

Mimoza Hysa: Anketat më të plota do të ishin shumë ndihmuese për të orientuar politikën e librit



Mimoza Hysa

Kulturës, Mimoza Hysa.

REAGIMI

"Falënderojmë shumë INSTAT-in që më në fund, pas kërkesave të vazhdueshme e bëri një anketë edhe për leximin. Por çfarë rezultat nga shifrat e publikuara?", pyet Hysa. Sipas saj: 1. Së pari, nuk kemi mundësi krahasimi me vitet e tjera, nëse është rritur apo zvogëluar numri i lexuesve; 2. Së dyti, nuk rezultoi se ka ndonjë dallim të madh mes fashave të moshave që nuk lexojnë, që

do të thotë se nuk është e vërtetë që moshë mbi 40 e lindur dhe edukuar në një periudhë tjetër të jenë lexues më të rregullt se 25-vjeçarët e lindur dhe rritur gjatë periudhës së tranzicionit. Por mund të dëshmojë dhe që lexuesit e dikurshëm kanë hequr dorë nga libri.

"3. Së treti, rezultoni se shqiptarët janë lexues shumë më të mirë se vendet më të zhvilluara europiane, gjë që më bën të dyshoj se edhe kësaj here nuk janë treguar

të ndershëm kur kanë deklaruar shifrat.

4. Së katërti, dhe më interesantja është se studimi në vendet e tjera përfshin dhe moshën 6 deri 25, pra moshën shkollore dhe atë moshë kur lexohet më tepër. Në Shqipëri, duke iu referuar tabelës, moshë shkollore nuk është pyetur. Duhet kuptuar atëherë se ata përbëjnë atë gati 2 milionë që lexon", thotë Hysa.

Ajo vëren se duke iu referuar shifrave, sipas publikimeve të secilit vend, nëse në

Shqipëri 35% deklaroi se nuk ka lexuar asnjë libër gjatë një viti, në Itali kjo shifër është 55% (6 në 10 italianë deklaroi se nuk kanë lexuar asnjë libër gjatë një viti), në Spanjë 37.8%, në Francë 31%, në Gjermani 31.3%, në Shtetet e Bashkuara 27%, në Kanada 16% dhe në Norvegji 10%.

"Nuk e di pse dalim në konkluzione dhe flasim pa bërë krahasimet, sidomos gazetarët që botojnë lajmin dhe nuk bëjnë krahasime paralele. Nuk është e barasvlershme të thuash sa nuk lexojnë në Shqipëri dhe sa shpenzohet për blerje librash në disa vende të botës. Uroj që të tashmë anketat të jenë të përvishme dhe më të detajuara. Psh. në Itali rezultojnë se një pjesë e mirë e klasës së drejtuesve dhe menaxherëve (38%) deklaroi se nuk lexojnë. Tek ne mund të dallojmë vetëm që numri i atyre që nuk lexojnë është më tepër nga ata me arsim të ulët. Anketat më të plota do të ishin shumë ndihmuese për të orientuar politikën e librit. Konkluzioni im kur krahasova shifrat ishte se ende shqiptarët nuk janë aq të ndershëm me veten sa të bëjnë deklarime të vërteta. Prandaj kisha më besim te francezët. Nuk ma merrte mendja se mund të ishin gati si ne dhe më keq se amerikanët...", - e mbyll reagimin e saj Mimoza Hysa.

Shkolla shqipe në Dardhë, shpallet Monument Kulture i kategorisë së I-rë



Josif Adamit, i cili ka qenë inxhinier në prefekturën e Korçës. Së pari, ngritja e një ndërtese të re në Dardhë nuk mund të shihet si një rast i shpëputur, por si vazhde e një zhvillimi të pandërprerë të urbanistikës dhe arkitekturës së fshatit. Në studimet historiografike janë venë në dukje transformimet që ndodhen në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendeve ballkanike, duke përfshirë dhe vendin tonë, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX- fillimet e shek. XX. Nga fun-

di i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX fillojnë e të ndjehen gjithnjë e më fort ndryshimet në fizonominë urbanistike të fshatit. Të dhuratat e nxjerra nga emigrimi i investuar kryesisht në ndërtimin e banesave, punishteve e dyqaneve, hoteleve e kafeneve dhe në punimet me karakter komunal: në shtrimin e rrugëve me kall-drëm, në sjelljen e ujit të pijshëm, në ndërtimin e çezmave etj. "Shkolla duhet të jetë me dhoma të larta dhe me dritare të mëdha, me

frone të rrallë dhe veç për çdo nxënës, i ndarë më dysh njëra për djemtë dhe tjetra për vajzat e ndarë brenda në tri ose katër dhoma... që do të jetë për shkollë dhe... sallë mbledhje, provime etj. Duhet marrë parasysh që shkolla të ngrohet me anë të një furre Veç kësaj, ju lutemi, të merrni në sy (toilet) ... Më që këtë punë duhet ta mbarojmë këtë behar dhe në është e mundur vjeshtën që vjen të venë fëmija në shkollën e re". Dokumentacioni i kohës na njehtë dhe mënyrën e organizimit të ndërtimit. Sistemi i dhënies me porosi për prodhimin e elementeve të rëndësishme arkitektonike njiheshe që në atë kohë. Prodhimi dhe vendosja e dritareve dhe dyerve të shkollës u porosit tek marangozët e njo-hur korçarë, siç ishte dhe firma e Themistokli Ligor Koços e Co. Gjatë shfletimit të materialit dokumentar ndeshemi dhe një koncept mjaft të përparuar për sa i përket shfrytëzimit të

ndërtësës, i barasvlerështëm me konceptin e sotshëm të "rijetëzimit të monumenteve". Përveç funksionit të shenjtë të edukimit dhe arsimimit të fëmijëve, funksionet e propozuara nuk duhet të binin ndesh me këtë funksion primar. Ata duhet të kishin karakter kryesisht kulturor, funksione të marra jo në mënyrë arbitrare, por mbas një diskutimi dhe vendimmarrjeje të gjerë dhe të formuluar në këtë mënyrë: Ndërtimi i shkollës pranë kishës së Shën Gjergjit, me funksionet e saj ndihmoi në krijimin e një qendri të re shoqërore në pjesën e sipërme të fshatit me karakter shpirtëror, edukativ e kulturor. Koleksioni i fotove të fotografit të shquar dardhar, Thimi Raci, na i pasqyrojnë më së miri aktivitetet e dendura që zhvilloheshin në këtë qendër: Aty janë celebruar martesat, janë festuar përvjetorët e festave kombëtare, janë demonstruar zëjt e ndryshme, është vallëzuar e gëzuar e shumë aktivitete të tjera.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 624

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Allaj

E shtunë 25 Gusht 2018

RIKTHEHET KALLASHI:

Ja arsyeja pse u largova nga Kosova



*Kam fituar 10 mijë
euro për një natë*

*"Kam dëgjuar
që më kanë
bërcënuar, por
s'kam asbuft
borsh"*

VIP-at NE PLAZH

Rikes i "shpërthen" gjoksi në plazh,
Roza Lati 'braktis' rrjetet sociale,
Suada Sherifi poston foton e parë me bashkëshortin



**SELDI DHE MIMOZA
JANË NDARË? KY DETAJ
NA BËRI TË DYSHOJMË**



LIDHET BANORJA E "BIG BROTHER 9"?, FJORENTINA HALILI: SI QËNDRON E VËRTETA

Flet kërcimtarja ekzotike: Kam fituar 10 mijë euro për një natë

I RIKTHEHET SËRISH KËRCIMIT, Kallashi: JA ARSYEJA PSE U LARGOVA

“Kam dëgjuar që më kanë kërcënuar, por s’i kam askujt borxh”

Pamela Aliaj

Pas një shkëputjeje të gjatë u rikthyet në Kosovë? Çfarë projekti do të sillni?

Unë isha aktive në Zvicër: Kam bërë mbrëmje, koncerte, pastaj u ktheva në Kosovë, sepse kisha nevojë për pushim. Ndërkohë që tani jam duke punuar tek “Princesha Palace”.

Thatë se do realizonit një këngë dhe videoklip. Është bashkëpunim apo solo?

Po, kam klipin tim, i cili është duke u realizuar. Por do ketë dhe bashkëpunim tjetër.

Cila është arsyeja e shkëputjes suaj nga klubi “Cobra City” dhe mbyllja e gjithë rrjeteve sociale?

Unë kam mbaruar kontratën në “Cobra City”, kjo ishte dhe arsyeja pse u largova. Ndërsa për sa i përket rrjeteve sociale, ato më janë vjedhur, nuk i kam mbyllur. Pastaj kam arritur të rikthej ‘Snap Chat’ dhe ‘Facebook’, kurse ‘Instagramin’ nuk kam mundur ta rimarr.

A keni pasur ndonjë kërcënim nga ndonjë personazh i njohur që ju detyroi të largoheshit?

Kërcënime? Jo, skam pasur direkt nga askush. Thjesht kam dëgjuar, por nuk kisha askujt borxh dhe s’kam frikë kështu që u ktheva në Kosovë.

Thatë se do hapnit klubin tuaj në Zvicër. Do të jetë vetëm me kërcime ekzotike?

Po, do të rihapet dhe do jetë normal.

Do te ketë kërcimtarë apo edhe këngëtarë?

Jo, do jetë diçka normale. Do jetë ‘Shaisha bar’, nuk do ketë lidhje me kërcimin.

Si qihet klubi?




Ak47

Pse pikërisht ky emër? A ka një domethënie?


AK47 nënkupton emrin tim, Kallashashi.

A ju ka ofruar ndonjë politikan apo personazh i njohur ndonjë shumë të majme për të kaluar natën me ju? Nëse po, Sa ka qenë shifra?

Ajo ‘u zhdruk’ papritur prej disa vitesh si nga rrjetet sociale ashtu edhe nga mediat rozë për të mos qenë më në qendër të vëmendjes me provokimet e saj të shpeshta. Por tashmë atë e shohim sërish. Donjeta Kosumi, e njohur ndryshe me nofkën ‘Kallashi’ i është rikthyer rrjeteve sociale dhe vendit të saj të lindjes, Kosovës. Ndërsa në postimin e saj të fundit, kohë më parë, njoftoi se do të hiqte dorë nga kërcimi, tashmë i është rikthyer profesionit të saj. Por çfarë ka ndodhur me Kallashin që nga ajo kohë e deri më tani? Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, ajo na rrëfen arsyet e largimit dhe të rikthimit në profesion dhe në Kosovë. Ka qenë e kërcënuar? Dikush e ka detyruar të largohet, apo ka qenë vendimi i saj? Për më tepër lexoni intervistën e mëposhtme:



Nuk kam pas kontakte me politikanë dhe si pëlqej këto oferta. **A ka pasur raste që kur keni kërcyer ju ka ngacmuar ndonjë? Si keni reaguar?** Po, ka ndodhur. Por e kam marrë më shumë me buzëqeshje. **Si ju ka ngacmuar? Me fjalë apo**



Do doja të jetoja larg vendit, ku nuk me njohin. Të iki dikund larg, e të krijoj një familje. Dhe s'dua të më njohin si Kallashi.

dhe me gjeste? Çfarë keni bërë konkretisht?

E kam qëlluar me shishe ose kam bërtitur.

Ka pasur raste që dikush është fiksuar pas jush e ju ka ndjekur kudo që shkonit? Nëse po, ka qenë personazh i njohur? Si keni vepruar?

Po ka pasur. Ka qenë shumë e vështirë, por normalisht na ndodh të takohemi në vende ku ka njerëz dhe nuk ka ndodhur diçka më shumë, sepse gjithmonë kam pasur kujdes.

Për çfarë gjëje do të hiqni dorë njëherë e mirë nga kërcimi? Në qoftë se do krijoj familje, normalisht nuk do kërceja si më parë.

A është dikush në jetën e Kallashit?

Kam pasur një lidhje të gjatë prej vitesh por tanimë jo.

A keni ndonjë plan për ndryshim rrënjësor në jetën tuaj?



Po. Do doja të jetoja larg vendit, ku nuk me njohin. Të iki dikund larg, e të krijoj një familje. Dhe s'dua të më njohin si Kallashi.

Cila është shifra më e majme që keni fituar në një mbrëmje që keni kërcyer?

Nuk mbaj mend saktë. 10 mijë euro.

Cila është dhurata më e shtrenjtë që ju kanë bërë?

Më kanë bërë dhurata të ndryshme. Më e shtrenjta ka qenë një makinë.

Nëse nuk do ishit kërcimtare, çfarë do donit të bënit në jetë?

Do doja të isha police.

Pse pikërisht police?

Po, sepse më shkojnë gjërat gangsta. Me siguri do ishin dorëzuar të gjithë kriminelët, vullnetarisht. (Qesh)

VIP-a në plazh

Rikes i "shpërthen" gjoksi në plazh, Roza Lati 'braktis' rrjetet sociale, Suada Sherifi poston foton e parë me bashkëshortin

Pamela Aliaj

Kjo është fundjava e parafundit e gushtit për këtë verë dhe prapë se prapë nuk mund të themi se pushimeve u ka ardhur fundi, e aq më tepër temperaturave të larta të kësaj stine të nxehtë. Vijnë për ne maratona e vip-ave që shijojnë në maksimum edhe këto dy javët e fundit të

relaksit. Dhe ne do të sjellim edhe kësaj radhe në fokus disa nga fotot më të bukura të kësaj vere. Dikush në jug të Shqipërisë, dikush në Amerikë e dikush në vendet fqinje, të shohim disa nga copëzat e pushimeve të njerëzve të famshëm për këtë fund vere.

Rike Roçi më seksi se kurrë, shijon pushimet në Itali




Pushimet e saj kanë nisur që në qershor e mesa duket ende nuk kanë përfunduar. Pas një udhëtimi nëpër Francë, Turqi, e Shqipëri, më në fund ishbanorja e 'Big Brother' është rikthyer në Itali. Edhe pse nuk ka qenë kohë e qëndrueshme, Rikja ka arritur të shijojë sado pak rrezet e diellit të këtij fund gushti. Në fotot e postuara në 'Instagram' ajo shfaqet në formë dhe shumë seksi duke ekspozuar gjoksin bombastik. E si të shfaqej ndryshe Rikja, vijon ende të tërheqë vëmendjen me format e saj!

"Nuk postoj më asgjë!" Roza Lati shijon pushimet larg rrjeteve sociale




Të jesh me pushime do të thotë të shkëputesh nga gjithçka dhe nga të gjithë. Këtë ka vendosur të bëjë edhe moderatorja e "Why Not", Roza Lati e ndalesën e saj të radhës e ka në Ulqin së bashku me shoqet e saj. Dy fotot e fundit të postuara të moderatorës shkruanin se u kërkonte ndjesë ndjekësve por s'do postonte më foto, sepse ishte duke shijuar pushimet. Dhe kështu duhet bërë!

"Jeta është një melodi", Ilva Tare poston foton e ëmbël me vajzën



Nuk para poston foto me familjen duke qenë se është mjaftueshëm diskrete. Por në të rrallë arrijmë të kapim ndonjë sekuençë të ndonjë fotoje të ëmbël të shkëputur nga momentet e saj me vajzat. Ilva Tare, tashmë nënë e dy fëmijëve, ka postuar së fundmi një foto me vajzën e madhe duke ecur në rërë e duke u kapur për dore. "Jeta është një melodi", shkruan gazetarja. Dhe vërtetë e tillë është kur je i rrethuar nga dashuria, siç shfaqet në këtë foto.


"Sa bukur është të ëndërrosh, përqafuar me ty", Suada Sherifi poston foton e parë të pushimeve me bashkëshortin



Ajo ka qenë gjithnjë e rezervuar lidhur me fotot që poston me bashkëshortin e saj. Por këtë verë, ajo që tërhoqi më tepër vëmendje ishte fakti se ish-misi shqiptar, Suada Sherifi, nuk postoi asnjë foto të saj apo të vogëlushes për këtë verë. Ndërkohë që jemi në fund të sezonit veror, ajo vendosi që për herë të parë të postojë një foto së bashku me bashkëshortin. Por kësaj radhe pa i treguar fytyrën. "Sa bukur është të ëndërrosh, përqafuar me ty", shkruan ndër të tjera Suada. E shtrirë pranë tij me rrobëbanjo të bardha, bukuroshja duket më se e lumtur.

Një kapitene seksi si Einxhel Shkira, po përvëlton Tuqinë

Pushimet ekzotike të Einxhel Shkires ku kanë të sosur! Nga Mikonos tani ajo është duke u shplodhur në një nga resortet e Turqisë. Por ajo që bie më tepër në sy nga fotot e postuara është trupi fantastik i bukuroshes, e cila falë kujdesit dhe palestrës arriti në një formë super-seksi. "Kam humbur 10 kg", ka thënë në një nga postimet në 'Instastory' Einxhel. Për t'u marrë shembull! Kjo tregon se me vullnet ia arrin gjithçkaje!



Alesia Bami i huton të gjithë, del toples në breg

Nuk kishte se si të mungonte në kolazhin tonë edhe modelja e tanimë Nvelina e "Stop"-it, Alesia Bami. Edhe pse është kritikuar gjithnjë për përdorimin e fotoshopit, ajo nuk rresht të postojë foto në 'Instagram'. Së fundmi ajo ka provokuar me format e saj bombastike duke nxjerrë në pah gjoksin. E ulur në gjunjë në breg, Alesia duket tepër provokuese. E veshur vetëm me një bluzë të hapur e me gjoksin jashtë duket se modelja nuk i lë vend fantazisë së meshkujve!



VIP-a në plazh


Çokollatë si Lori Hoxha, ja ku po i shijon pushimet blogerja

Ajo njihet për jetën luksoze dhe udhëtimet e shpeshta që bën. Njëherë në Maldive e njëherë në Mikonos, blogerja e njohur, Lori Hoxha duket se çdo ditë të vitit është me pushime dhe i shijon ato në maksimum. Kësaj radhe ajo shfaqet si gjithnjë në formë fantastike e veshur me bikini nude dhe me një ngjyrë çokollate në lëkurë që është për t'u pasur zili. Ndërkohë që më parë, pas dasmës së të motrës, Lori u dyshua se ishte fejuar me të dashurin e saj Vis Bajraktarin, gjë që u hodh poshtë nga vetë blogerja. Por vërtetë, pas Sarës e ka radhën Lori të kurorëzojë dashurinë e saj disavejeçare.



"Jeta e një nëne", Bora poston foton e veçantë me djalin

Gjithmonë bashkë i shohim. E si të largohet nga dashuria më e madhe e jetës së saj Bora Zemani. Së bashku me Arbnorin, ne e shohim se si është duke i shijuar pushimet e saj moderatoja e Digitalb. "Jeta e një nëne", ka shkruar në një nga fotot e postuara në 'Instastory', ndërkohë që shihet me një palë bikini të kuqe, në superformë me një kapele të zezë që është duke i sjellë kovën me ujë djalit të saj. E ku ka pushime më të bukura?



Rrëfihet grimierja nga Tirana: Kam një vit që s'flas me Sidritën. Janë gënjeshtra!

Lidhet banorja e "Big Brother 9"?, Fjorentina Halili: Si qëndron e vërteta

Poston foto me Dj në Sarandë, 'plasin' urimet në Instagram

Pamela Aliaj


Edhe pse tashmë u bënë dy vite që kanë dalë nga shtëpia më e famshme në Shqipëri, "Big Brother", banorët e saj ende vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes nga mediat rozë. Pak ditë më parë, në një nga statuset e saj, Fjorentina Halili e "Big Brother 9", postoi një foto me një djalë duke i vënë si digjiturë një zemër. Vetëm kaq mjaftoi që të shpërthehin hamendësimet dhe komentet nëpër mediat rozë, por s'pati asnjë reagim të vetë ish-banores. Ndërkaq, e kontaktuar nga "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Fjori foli për herë të parë lidhur me të vërtetën e këtij lajmi që qarkullonte nëpër media. Ajo ka thënë se nuk është "as po as jo". Pra, ende e ka mbajtur të vagullt përgjigjen nëse ka ndonjë lidhje me Dj më të njohur të jugut. Por të themi atë që shohim, ata duken shumë të këndshëm së bashku! Ndërkaq që Fjorentina nuk ka dashur ta aprovojë përfundimisht lidhjen e tyre, neve na mbetet vetëm të presim kur ta bëjnë formale të dy!

Ndërkaq kujtojmë se Fjorentina Halili, grimierja nga Tirana, që u bë e famshme për tipin e saj të veçantë në "Big Brother", në foton e postuar në 'Instagram', ajo pozon pranë një Dj shumë simpatik, që njihet si Mr.Rodolf. Kaq ka mjaftuar dhe kanë vërshuar urimet e miqve: "Sa shkoni", "Të dy yje", "Si zemra të dy", "Sa mirë, na bëhet qejfi për ty", "I dashuri zemër, yll të dy", "Jeni shumë të mirë", etj., janë disa komente, që miqtë i kanë bërë Fjorentinës poshtë fotos. Ndërsa ajo s'ka preferuar t'u përgjigjet atyre, duke e lënë një mister këtë foto, ku pozon kaq afër në Sarandë me Dj-in, i cili ndodhej për të luajtur muzikë në një nga klubet verore të qytetit bregdetar. Ndërkaq vëmë re se në 'Instagramin' e djaloshit nuk ka



asnjë foto të të dyve. Pra, paskan vendosur të heshtin të dy për momentin.

Ndërsa për sa i përket fjalëve që dolën lidhur me marrëdhëniet që kishte me banorët e "Big Brother 9", ajo vendosi t'i përgënjeshtroi edhe zërat. Fjori ka thënë se ka më tepër se një vit që është shkëputur dhe nuk flet më me Sidritën, një nga banoret e shtëpisë së madhe, ndërkaq ka shtuar se marrëdhënie të mira mban vetëm me Donald Grodanin dhe Dona Pjetrin.



Paska pasur 2 vajza dhe nuk e dinim, **ZAIMINA** publikon foton e vajzave të bashkëshortit

Vetëm pak muaj më parë, Vasjari dhe partneri i saj, Klodian Asllani, u bënë prindër. Prej gati 13 vitesh ata janë bashkë dhe tanimë Khloe, e ka bashkuar edhe më tepër çiftin. Por duket se ardhja e saj në jetë ka lumturuar edhe dy vajzat e Klodianit, për të cilat nuk dihej asgjë, të paktën deri më sot. Zaimina ruan marrëdhënie të mira me dy vajzat e Klodianit, Kristel dhe Jennifer. Ndërkohë që para dy ditësh, familja e madhe është bashkuar për të festuar ditëlindjen e vajzës së dytë të Klodianit, Kristel, e cila mbushi 13 vjeç. Zaimina ka publikuar foto nga ditëlindja e "princeshës" siç e quan ajo. Më pas tre motrat kanë pozuar në një foto të ëmbël, të veshura me rozë, dhe Zaimina e ka ndarë atë në profilin e saj në Instagram. "Dashuri mes motrave", shkruan Zaimina në foton e publikuar ku shihet Jennifer që mban në krahë Khloe-n e vogël. Dy vajzat Kristel dhe Jennifer jetojnë në Itali, së bashku me nënën e tyre, ish-partneren e Klodianit.



Zhvishet **RITA ORA**, provokon duke prekur gjoksin

Nuk është hera e parë që ajo zhvishet dhe provokon me format e saj fansat. Kësaj radhe, këngëtarja me famë botërore, Rita Ora, ka preferuar të veshë vetëm një këmishë të bardhë dhe asgjë poshtë duke pozuar në foto tepër provokuese. Në poza duke prekur gjoksin, Rita duket tepër ndjellëse. Një seksbombë e vërtetë shfaqet këngëtarja, e cila së fundmi ka arritur të rrëmbejë dhe një çmim në festivalin e fundit të VMA, si shqiptarja e parë së bashku me Bebe Rexhën.



E zbuluam më në fund! **LEDRI VULA** s'e fsheh dot më të dashurën

Ai është padyshim një nga djemtë më të pashëm, e njëkohësisht të talentuar të showbiz-it shqiptar. Prej muajsh flitej se Ledri Vula është në një lidhje me një vajze që jeton në Gjermani, por çifti ka qenë përherë diskret duke mos dalë publikisht. Por duket se në ditëlindjen e mikut të tij Ermal Fejzullahu, këngëtarit reper vendosi të dalë hapur me të dashurën e tij Sara duke na njohur kështu edhe me portretin e saj. Prive ka postuar një foto teksa duket bukuroshja nën shoqërinë e Ledrit dhe këngëtarit Lumi B. Sara jeton në Gjermani dhe thuhet se është mbesa e peshëngritësit të njohur shqiptar Telat Agolli.

"Kimikati" largohet nga "Portokalli" për t'iu bashkuar Besit dhe Erionit?

Largimi i 'Kimikati' nga spektakli i humorit 'Portokalli' u konfirmua më parë nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale nga Olsi Bylyku, i njohur ndryshe si 'Kimikati'. Pas këtij lajmi në media qarkulluan zëra se ai u largua nga 'Portokalli' për t'iu bashkuar projektit të Bes Kallakut dhe Erion Isait në 'Tv Klan'. Këto dyshime janë ngritur edhe më tepër pas një fotografie që të tre aktorët kanë postuar para dy netësh në rrjetet sociale: 'Radhën e kanë dajat... ja edhe pak' - ka shkruar Besi bashkangjitur fotos me miqtë e tij aktorë. Me këto fjalë duket sikur Besi paralajmëron një projekt të ri që do të vijë së shpejti. Deri tani ende nuk ka një konfirmim zyrtar nga ana e tyre. Na ngelet të presim fillimin e sezonit të ri televiziv.




LUANA mundohet ta 'fshehtë' Krenarin, por Getoari zbuloi të vërtetën!

Kanë më shumë se dy vite të lidhur, por për Luanën dhe të dashurin e saj Krenarin mesa duket nuk ka ardhur ende momenti për dalje publike si çift. Pavarësisht se dedikime të biznesmenit ndaj të moderatores nuk mungojnë në rrjete sociale, e po ashtu çifti ka shkuar shpesh nëpër evente të ndryshme së bashku, Krenari ende mbetet një portret pothuajse anonim për publikun. Por për kureshtjen e të gjithëve ka qenë pikërisht 'kunati' i tij Getoari ai që ka zbuluar të dashurin e Luanës nëpërmjet një foto në 'Instagram'. Foto është shkrepur fundjavën e kaluar në Como, motrat Vjollca së bashku me partnerët e tyre kanë qenë të ftuar në dasmën e Sarës dhe Ledionit!



SELDI dhe MIMOZA janë ndarë? Ky detaj na bëri të dyshojmë

Bashkë në skenë, në shtëpi, në koncerte e kudo. Mimoza BShkodra dhe Seldi Qalliu u fejuan vitin e kaluar dhe çdo gjë dukej se po shkonte për mrekulli mes tyre. Dyshja shfaqeshin tejet të dashuruar dhe publikonin vazhdimisht foto me njëri-tjetrin. Mirëpo, diçka ka ndodhur mes tyre, pasi çdo foto e bukur që ata kishin bashkë në 'Instagram' nuk gjendet më në profilin e asnjërit. Të dy i kanë fshirë foto së bashku, thjesht Seldi ka mbajtur posterat e koncerteve me Mimosën. Nga ana tjetër në profilin e Mimosës nuk gjendet asnjë foto e Seldit. Ata vazhdojnë ta ndjekin njëri-tjetrin, por kjo fshirje e fotove nuk është shenjë e mirë. Ndoshta çifti nuk po kalon një periudhë të mirë në fejesën e tyre.




BEBE REXHA vjen së shpejti në bashkëpunim me David Guetta

Këngëtarja shqiptare Bebe Rexha do të vijë së shpejti në një bashkëpunim me David Guetta. 'Say My Name' titullohet kënga që do të jetë pjesë e videoklipit të ri të DJ francez me Beben. Ky është albumi i shtatë i DJ dhe është titulluar '7'. Përveç Bebe Rexhës, ai ka bashkëpunuar dhe me emra të mëdhenj të muzikës si Justin Bieber, Nicki Minaj dhe Lil Uzi Vert.



ENI KOÇI dhe GENCI së bashku me pushime, ja detaji i veçantë

Dy këngëtarët e njohur, Eni Koçi dhe Genc Prevlukaj prej disa kohësh janë përfolur se janë në një lidhje dashurie, të cilën nuk e kanë konfirmuar asnjëherë publikisht. Gjatë gjithë kohës nuk kanë munguar postimet me nënkuptime apo tekstet e dedikuara, apo edhe rastet kur janë përfolur se janë ndarë. Mirëpo ndërkohë që nuk e pranojnë publikisht lidhjen e tyre, fotot e postuar së fundmi prej tyre në profilet e tyre në 'Instagram' na e vërtetojnë edhe një herë se ata janë bashkë. Eni dhe Genci kanë postuar foto ku na tregojnë se janë me pushime, por fansat kanë kapur detajin se bëhet fjalë për të njëjtin vend. Me sa duket, pas koncerteve të shumta që kanë pasur gjatë kësaj vere, Eni dhe Genci janë duke kaluar disa ditë pushimesh së bashku në Budva.



Eseja e Ditës

Kur Shqipëria ishte e vetmuar në fatin e saj

Nga Paolo FORESTI

(vijon nga faqja 1)

... me autoveturë. Edhe pse miku im i shquar ishte i akredituar në të dy vendet, e lamë atë në kufi dhe udhëtuam me një makinë të ambasadës franceze në Tiranë.

Gjatë tre orëve të udhëtimit na ndiqnin agjentë të Sigurimit të Shtetit, i frikshmi Sigurimi, që nuk na u ndanë asnjëherë, edhe kur Pierri e detyronte shoferin shqiptar të bënte pa pëlqimin e tij devijime të vogla gjoja për kryerjen e nevojave urgjente. «Engjëjt tanë mbrojtës» afroheshin menjëherë te vetura jonë duke na rikujtuar me një frëngjishte perfekte se nuk duhej në asnjë rast të devionim nga itinerari i parashikuar.

Gjatë rrugës, pamë jo më shumë se një duzinë veturash dhe pak kamionë. Shumica e shqiptarëve lëviznin me këmbë, të tjerët, më me fat me biçikletë ose me karroca që tërhiqeshin nga kuajt.

Tirana na u duk e rregullt dhe e pastër, por ajo që më çudit ishte sjellja e banorëve: të gjithë kalimtarët me të cilët kryqëzoheshim në rrugë ulnin kokat ose kalonin në trotuarin tjetër. Pierri më shpjegonte se shqiptarët donin të evitonin të gjitha kontaktet me të huajt, që të mos i shihnin, nga frika se do të merreshin egërsisht në pyetje nga Sigurimi.

Kontakti im i dytë me Shqipërinë daton në vitin 1985, pas vdekjes së Enver Hoxhës. Ndërmjet Romës dhe Tiranës shpërtheu një krizë e rëndë diplomatike kur pesë shtetas anëtarë të familjes Popajt, me origjinë nga Durrësi kërkuan strehim politik në ambasaden italiane në Tiranë. Roma refuzonte me kokëfortësi t'i dorëzonte ata te policia shqiptare. Shefi i qeverisë italiane, Giulio Andreotti vendosi të më dërgonte te vendi i shqiptonjave në përpjekje për gjetjen e një rrugëdaljeje nga ajo krizë. Në fakt, viza e hyrjes as m'u

Tirana na u duk e rregullt dhe e pastër, por ajo që më çudit ishte sjellja e banorëve: të gjithë kalimtarët me të cilët kryqëzoheshim në rrugë ulnin kokat ose kalonin në trotuarin tjetër. Pierri më shpjegonte se shqiptarët donin të evitonin të gjitha kontaktet me të huajt, që të mos i shihnin, nga frika se do të merreshin egërsisht në pyetje nga Sigurimi.



dha dhe as m'u refuzua, por më në fund u vendos që të hiqnim dorë nga ky mision. Pesë vjet më vonë, pas shembjes së Murit të Berlinit dhe ngjarjeve

që ndodhën më pas, qeveria komuniste e Ramiz Alisë dëshironte ta zgjidhte konfliktin me Romën dhe pranoi transferimin e Popajve në Itali. Mirë kjo ndoshta mund të

interpretohej si një sinjal për të gjithë ata që donin të largoheshin nga vendi të cilës qeveria shqiptare i druhej gjithmonë. Në atë kohë, turma të mëdha

njerëzish përpiqeshin të hynin në ambasadat perëndimore në Tiranë për të marrë një vizë. Një mijë shqiptarë vinin në ambasaden italiane, shumë të tjerë ndaloheshin nga policia ose tentonin të kapërcenin kangjellat e larta mbrojtëse të këtyre ambasadave.

Më 1991, si Këshilltar Diplomatik i Ministrisë të Mbrojtjes u angazhova me përgatitjen për Operacionin Pelican. Mbi 1000 ushtarë italianë transportuan dhe shpërndanë ndihma ushqimore në territorin shqiptar, duke dhënë një kontribut vendimtar për stabilizimin e gjendjes ekonomike të vendit.

Një vit më vonë, shoqërova Presidentin Scalfaro gjatë vizitës së tij zyrtare në Tiranë.

Ndërsa, në vitin 1993, u emërova ambasador i Italisë në Shqipëri në një atmosferë tejet të tensionuar. Ai funksion, që e ushtrova për katër vjet rezultoi jashtëzakonisht i ngarkuar dhe shpesh i dhimbshëm; gjithsesi, më duhet të pranoj dhe vlerësoj faktin se ato ishin vitet më pasionante dhe më të pasura të jetës time. Misioni im diplomatik përfundoi në momentin e shpërthimit të «piramidave famëkeqe financiare», që provokuan pothuajse një luftë civile.

Për fat të mirë, gjendja u vu nën kontroll me shpejtësi, falë veprimit të vendosur dhe vendimtar të komunitetit ndërkombëtar, sidomos të Italisë, me mbështetjen e BE-së dhe SHBA-ve.

Qysh atëherë, nuk jam ndarë më nga Shqipëria. Edhe tani në pension në fshatin e qetë Ombrile, të rrethuar me ullinj mijëvjeçare, vazhdoj të ndjek zhvillimet e vendit ku kam shumë miq. Kështu, p.sh., gjatë viteve 2006 - 2014 isha Rektor i Wisdom University të Tiranës, ku kontribuova për themelimin e tij.

Libri i Sébastien Vilmot, 'Albanie, la solitude d'un destin', (Shqipëria, fati i një vendi të vetmuar) është një ilustrim i shkëlqyer i historisë së mundimshme të atij vendi të vogël, që ka dalë nga mjegulla që e kishte mbuluar gjatë 50 viteve të fundit.

I pasur me referenca të shkurtura dhe elokvente, libri jep një panoramë të gjerë të dramaturgjisë së jetës shqiptare: epokës ilire, arritjet e Heroit Skënderbeu, Pavarësisë nga sundimi otoman për ta mbyllur me një përshkrim shumë të goditur të ardhjes së komunizmit dhe ingranzahet e diktaturës së Enver Hoxhës.

Për të gjithë ata që duan të kuptojnë ose dhe thjesht të rirreskojnë disa nga faqet me të pabesueshme të historisë evropiane, të lëna për në kohë të gjatë në kufijtë e harresës, nuk ka mënyrë më të mirë se sa të «zhyten» në këtë botim me plot fakte të reja.

Përgatiti për "GSH" Jorgji Kote


“Shqipëria, fati i një vendi të vetmuar”, libri i autorit francez me parathënie të Paolo Forestit

Në muajin korrik 2018 u promovua në Paris libri i autorit francez Sébastien VILMOT « La solitude d'une destin » (Shqipëria - Fati i një vendi të vetmuar) që është i disponueshëm dhe në internet nëpërmjet Amazon fr.

Ky libër i ri është produkt i një pune shumëvjeçare kontaktesh, intervistash, takimesh dhe konsultimesh me personalitete shqiptare dhe të huaja dhe me kërkime të panumërta në arkiva të huaja nga një njohës fin i Ballkanit dhe tejet i apasionuar pas historisë së vendit tonë, nga lashtësia deri në ditët e sotme.

Ndër të tjera, Vilmot ka shkëmbyer ide e mendime me ish-Presidentin Rexhep Meidani, kryetaren e Grupit Parlamentar të Miqësisë Francë - Shqipëri, zonjën Viviane de Dissez, nipin e ish - Mbretit Zog, Skënder Zogu, familjarë të të ndjerit Pjetër Pepa ish-ambasadori ynë i parë në Vatikan dhe autor i librit « Pageine sulla dittatura », profesorin e feve në Universitetin e Romës, Roberto Morozzo della Rocca, ambasadorin e Shqipërisë në Francë, Dritan Tola, këshilltaren e Kulturës në ambasaden franceze në Tiranë, Rose - Anne Bisiaux, shkrimtarët Bashkim Shehu dhe Besa Myftiu, autorin e disa librave mbi komunizmin, Ylli Demneri, etj.

Gjithashtu, ai ka bërë udhëtime të shumta në Paris, Romë/Milan, Bruksel, Gjenevë, Londër, Cambridge dhe në metropole të tjera të mëdha evropiane. Vilmot ka qenë, gjithashtu, në Shqipëri, Kosovë dhe Bosni&Hercegovinë.



Autori i ka mbështetur të dhënat dhe përfundimet e tij me materiale të shumta e të besueshme referuese dhe me fragmente nga 120 botime dhe romane prestigjioze; duke filluar nga gjeniu i letrave shqipe, Ismail Kadare, shkrimtarë/publicistë të tjerë të njohur, si Fatos Kongoli, Besnik Mustafaj, Fatos Lubonja, Fahri Balliu, Blendi Fevziu, Amik Kasoruhu, Uran Butka, Shaban Sinani, Ylljet Aliçkaj, Lek Pervizi dhe Safet Kryemadhi, njohësit dhe personalitetet e historisë sonë Edith Durham, Robert Elsie, Miranda Vickers, Noel Malcolm, Herman Bernstein, etj.

Editori i librit, Vincent de Crayencourt nënvizon ndër të tjera se pak botime të kësaj natyre kanë mundur të shpëgojnë bindshëm se si brenda fare pak vitesh Shqipëria u kthye nga një mbretëri e vetësh-

pullur në diktaturën më të egër të shekullit të XX.

Por, autori jep dhe mendimet e veta mbi periudhat dhe personalitetet madhore të historisë së këtij vendi, sidomos për Skënderbeun, Zogun, Fan Nolin, Enver Hoxhën, Ramiz Alinë e të tjerë; krahas denoncimit dhe qëndrimeve kritike, sidomos për periudhën e monizmit, Vilmot nuk nguron të përmendë bindshëm edhe dukuri të caktuara pozitive për secilën prej këtyre periudhëve, duke iu shmangur vlerësimit «bardhë e zi».

Ndërkohë, duke shigjetuar përgjegjësinë e faktorit ndërkombëtar, Vilmot shpreh se «e sunduar nga otomanët, e injoruar nga Bismarku, e braktisur nga Lidhja e Kombeve dhe e aneksuar nga Italia, Shqipëria është instrumentalizuar dhe tradhtuar nga protektorët e saj».

Ky botim ka pasur menjëherë jehonë pozitive të lexuesit e huaj; këta të fundit i kanë vlerësuar të 11 kapitujt me 247 faqe të librit si një «guidë dhe sintezë të gjallë të historisë së një vendi të panjohur, por të mrekullueshëm që të mahnit nga kapitulli në kapitull».

Nisur nga sa sipër, vështirë të kishte një hyrje më të mirë se parathënia e shkruar nga Zoti Paolo Foresti, ambasadori i Italisë në vendin tonë gjatë periudhës së tensionuar dhe shpërthyes 1993 - 1997. Ai vazhdon të jetë mik, mbështetës, njohës i shkëlqyer dhe shtetas i vendit tonë.

Për kënaqësinë e lexuesit po e japim këtë parathënie dhe në shqip.

Opinion **i** Ditës

Erdhi koha që t'i veshim rrobat e ushtrisë?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... por edhe faturën financiare që lidhej me të. Po mundohemi ta perifrazojmë: "Jam i habitur nga fushata që ka nisur në pjesën e mediave kundër idesë së rivendosjes së shërbimit ushtarak, duket qartë se është e sinkronizuar, sepse në një moment tjetër u informua se Serbia kishte plane të reja, që avionët që do të marrim do të emërohen sipas pilotëve që vdiqën në vitin 1999 në mbrojtje të agresionit të NATO-s". Dhe, më vonë, vijonte cinizmi: "Është e vështirë për ju të mendoni për një shtrat për tre muaj dhe t'i vendosni pizhame nën jastëk, por nga ana tjetër pretendoni të sulmoni Kaçanikun dhe Gjakovën, po pse gënjeni e mashtronin?"

Nuk është kjo arsyeja e vetme dhe më e vogla për rikthimin e shërbimit ushtarak, por një shqetësim, që njësoj besojmë se e ndajmë shumë njerëz në Ballkan. Të rinjtë janë gjithnjë e më të palexuar (Shqipëria e konfirmoi me të dhënat e fundit të INSTAT: një e treta e shqiptarëve nuk lexojnë), më të pastërvitur, më të paedukuar dhe shumë të pandërgjegjshëm për fatet e vendit të tyre. Kuptohet se numri është relativ pasi mbi një pjesë të madhe të të rinjve ka kapluar varfëria dhe pjekuria ka ardhur para kohe, kurse masa më e madhe e të rinjve (por edhe fëmijëve), qoftë dhe të rriturve të moshës së mesme duan të ikin. Në argumentin tonë, dukshëm një pjesë e vogël e të rinjve duket krejtësisht e pandërgjegjshme për identitetin, fatet e vendit dhe mbi të gjitha e pazonja për gjërat më elementare të jetës.

Një pyetje normale që të vjen në këtë moment duket e thjeshtë: Po çfarë do të bëjë mobilizimi ushtarak për të riun shqiptar?! Kuptohet se në kohën tonë politikat e sigurisë kanë ndryshuar dhe Shqipëria është pjesë e një ombrelle të përbashkët të Aleancës së NATO-s. Shqipëria u angazhua në Samitin e fundit dhe madje ka marrë lavdërimi nga z. Trump se do të përafrojë deri 2% të buxhetit të saj për mbrojtjen. Anipse, Shqipëria e sotme i ngjan një vendi krejtë pacifik dhe me sytë nga qielli, me pak fjalë që mbrojtja na vjen nga vendet e NATO. Dhe për këtë shërben edhe sanksionimi i "Artikullit V" të Dokumentit themeltar të NATO-s, që pak a shumë bën me dije se sulmi ndaj një vendi të Aleancës duhet konsideruar si sulm ndaj të gjitha vendeve. Ndërkohë, specialistët harrojnë "Artikullin III", që të kthellohet në përballja e parë ndaj çdo agresioni duhet bërë me infrastrukturën e përvëçme, që do të thotë me ato që kemi



trashëguar dhe ato që kemi ndër-tuar. Kjo të vjen ndërmend kur mendon se për fat të keq, Serbia është duke u armatosur me një ritëm jo normal dhe këtë po bën Kroacia. Vendet e ish-Jugosllavisë jo thjeshtë ndjehen të pasigurta, por po i justifikojnë rritjet e kapaciteteve të tyre me armët konvencionale dhe me blerjet e aeroplanëve dhe tankeve modernë por edhe në rritje të vazhdueshme të buxheteve ushtarake. Shenjë që të bën të mendosh se indiferenca është e tepërt. Por, t'i lemë fqinjët veriorë. Më në jug, nga ana tjetër, Greqia, asnjëherë nuk e ka ndër-prerë shërbimin ushtarak dhe po ashtu edhe Turqia, dy vende që janë vërtetë në një kulm, por që shpesh kanë qenë drejt incidenteve reale. Në këtë arsyetim kemi lënë Zvicrën, Austrinë dhe vendet nordike, që tashmë kanë kaluar në hapa të tjera të detyrimit ushtarak.

Në fakt, qëllimi i artikullit ishte ta ndante shqetësimin në dy dimensionë. I pari i mbrojtjes kombëtare dhe i rritjes së vetëdijës për problematikën komplekse të Sigurisë ku gjendemi, por e dyta është krejtësisht social-edukative. Nëse problemi do të shtellohej si duhej, atëherë duhet t'i paraprinte një studim për buxhetin që do ta përballonte këtë ndërmarrje dhe sesa shteti vetë do të kontribuonte në rastet e rekrutimit të individëve të familjeve të varfra.

Shërbimi ushtarak nga ana tjetër, do të ndihnte pak a shumë për të rinjtë që deri më sot punë të parë kanë anëtarësimin në forumet politike, ku zakonisht u bëhet propagandë deri në lavash truri, të një-

heshin me një nga detyrat më të shenjta: mbrojtjen e atdheut, por edhe faktin se para tij të ishin të barabartë. Në një farë mënyre, pa hyrë në hullitë politike, të rinjtë do të gjendeshin në një strukturë që i barazonte në përgjegjësi dhe detyra.

Mund të quhet e tepërt për disa dhe padyshim për pinjollët e pasur dhe familjet e tyre që do të geshin me cinizëm, sepse u mjaftojnë paratë për t'u shmangur shërbimit ushtarak, aman kryerja e shërbimit mund të shërbejë si një kredit personal për individin dhe një hap krenarie në çdo Cv: "Unë i shërbeva atdheut tim në vitin...nga...në...".

Jemi të ndërgjegjshëm që shkolla për shkak të ndikimit të madh politik, reformave të shpeshta dhe me bazë jo të gjërë mirëkuptimi ka krijuar tollvi. Ajo nuk po kryen dot as detyrën bazike, fakt që shikohet me nivelin gjithnjë e më të ulët të të diplomuarve, kurse një pjesë e të rinjve e kryejnë thjesht për të pasur një diplomë, që shpesh nuk hyn në punë për asgjë. Ndërkohë që shërbimi ushtarak do t'i përballe me barazinë, para një detyre të përbashkët të shenjtë, që i bën të rinjtë të njohin e të vlerësojnë më mirë identitetin e tyre kombëtar, por edhe të njihen me sfidat e përbaljes së kulturave të tjera e më gjërë.

Paçka zhvillimeve moderne dhe cinizmit që shprehet për forcën e mjeteve, fuqia e njeriut do të jetë gjithnjë vendimtare. Tek e fundit, është njeriu që drejton, ai që përdor armët, ai që bën politikat e kështu me radhë.

Shqipëria nuk ka kulturë të

mirë për thirrjen e referendumeve prej manipulimit të frikshëm, që i bëhet publikut, por ka ardhur koha të përgatitet një referendum i tillë. Është i mirëpritur rezultati pozitiv, sepse shërbimi ushtarak e mëson të riun të njihet me vlerat e vërteta që shikohen në marrëdhëniet reale në terren, përmirëson karakterin kombëtar të individit, rrit edukimin dhe respektin e të rinjve për jetën dhe vësh-tirësitë që kanë kaluar paraardhësit e tyre.

Mbi të gjitha sikur të kujto-hesh vetëm për sublimitetin që rrjedh me ngritjen e flamurit kombëtar në mëngjes, përkorjen që të kërkon shërbimi ditor dhe përgatitjen për detyrat kupton sesa shumë vlen detyrimi ndaj Shqipërisë, eliminohen ndarjet provinciale dhe identitare, kaq të shumta sot, dhe mbi të gjithë mësohet sesi të jetohej së bashku. E gjitha, në një farë mënyre, rrit ndërgjegjen publike, sepse realisht në kohën tonë po rritet gati në një humnë hapësira e jashtëzakonshme me atyre që detyrohen dhe të drejtave të të cilët.

Pak kohë më parë qeveria nxori një VKM, sipas të cilës, shqiptarët duhet të mobilizoheshin në situata të jashtëzakonshme. Që atëherë me përjashtim të pak rasteve, që e përmendin specialistët, ai është harruar. Përvëçse na e kujtojnë mirë fqinjët dhe më shumë tolllovia kombëtare ku jetojmë se ka ardhur koha që shqiptari duhet të verë kapelën ushtarake.

(Gazeta Shqiptare)

HOROSKOPI

DASHI

Sot energjia juaj fizike dhe mendore duhet të funksionojë në një nivel shumë të lartë. Mund t'ju lindë dëshira për t'u marrë me stërvitje. Dita e sotme është e shkëlqyer për të dalë në mbrëmje, ndoshta në një koncert, ose film.

DEMI

Intuita juaj do të jetë shumë e mirë sot për të kuptuar disa padrejtesi që mund t'ju bëhen. Kjo aftësi do t'ju mundësojë një reagim më të shpejtë për t'i paraprirë problemeve që mund të dalin gjatë ditës.

BINJAKET

Një bisedë me miqtë ose takimet me një grup njerëzish do t'ju fusin në mendime. Do të kuptoni se keni humbur shumë kohë me njerëz fals të cilët asnjëherë nuk jua kanë dashur të mirën.

GAFORJA

Sot gjërat mund të jenë mjaft stresuese në punë. Megjithatë rezultatit do t'ju kënaqë. Mos u habitni nëse kolegët ju bëjnë shumë komplimente. Mbrëmja parashikohet e shfrenuar.

LUANI

Keni një dëshirë të madhe për të takuar personin e zemrës që mund të jetë larg jush. Gjendja shpirtërore nuk është e mirë pikërisht për këtë mungesë. Këshilloheni që të merreni me aktivitet për të tejkaluar këtë situatë.

VIrgjerësha

Sot ju mund të mësoni rreth mënyrave të reja dhe krijese për të rritur të ardhurat tuaja. Ndoshta teknologjia do të jetë një mbështetje për ju në këtë aspekt. Shpenzoni më shumë kohë me familjen.

PESHORJA

Aktivitetet sociale mund t'ju vënë në kontakt me njerëz interesantë dhe shumë intrigues. Ju mund të përfshihen në disa biseda interesante që ju japin shumë informata të dobishme. Disa nga ato që dëgjoni mund të jenë shumë të çuditshme.

AKREPI

Një mik apo koleg do t'ju japë disa ide interesante për një investim. Sigurohuni që të merrni sa më shumë informacion në disa burime të tjera përpara se të hyni në vepër.

SHIGJETARI

Sot do të jeni i frymëzuar për të çuar përpara projektet dhe qëllimet tuaja. Në fushën profesionale gjërat do të ecin mjaft mirë ndërsa sa i përket dashurisë bëni një hap para dy hapa prapa.

BRICJAPI

Prisni disa lajme interesante, por ato mund të vonojnë. Mos u dorëzoni edhe pse prej kohësh jeni bërë shumë pesimist. Mundohuni të mblidhni energji të mira përreth jush duke menduar pozitivisht.

UJORI

Mos u habitni nëse mermi lajme të mira në lidhje me një investim që keni bërë shumë kohë më parë. Edhe pse i kishit hequr shpresat, hëna në shenjë tuj dhe ndërvëprimi planetar do ju favorizojnë.

PESHQIT

Keni shumë nevojë për frymëzim. Aktivitetet kulturore do ju bëjnë mjaft mirë. Mos humbisni kohë vetëm brenda ambienteve të punës, por rezervoni hapësirë edhe për velen tuaj dhe dëshirat që mbushin zem-

